

Valbona Duraj

LIBËR MËSUESI MUZIKA 10

BOTIME



I dashur koleg!

Muzika qëndron mes të gjitha formave të tjera inteligjente të njeriut (artit në përgjithësi, shkencave shoqërore e historike dhe shkencave artistike), si një përbërës i barabartë me to i progresit intelektual dhe i humanitetit.

Vazhdimi i rrugëtimit të njohjes me muzikën është një vlerë e madhe për të mundësuar *edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të dëgjuar në mënyrë të pavarur e sistematike vepra të ndryshme muzikore si dhe për të menduar dhe gjykuar në mënyrë kritike rreth tyre.*

Muzika nuk mund të kuptohet dhe realizohet duke marrë vetëm disa njohuri, por duke vazhduar njohjen më të plotë të saj përmes *gjuhës muzikore dhe komunikimit* nëpërmjet saj, të njohjes me veprat muzikore, konkretizimin e njohurive muzikore përmes realizimit të *technikave dhe proceseve*, si dhe njohjes me *zhvillimin kulturor dhe historik të muzikës*, njohuri që bëjnë të vetëdijshëm nxënësin për rolin e muzikës në jetën e përditshme dhe vlerësimin e saj nëpërmjet një gjuhe të saktë muzikore.

Muzika edukon nxënësin nga pikëpamja estetike dhe muzikore, duke e orientuar atë në mënyrë të saktë drejt kuptimit të vlerave estetike dhe muzikore nga abstraktja te konkretja, në njohjen me gjinitë dhe llojet e ndryshme të muzikës, si dhe me zhvillimin historik të muzikës në periudha, kontekste dhe kultura të ndryshme.

Pse shërben ky libër?

Ky libër do të udhëheqë mësuesit në zhvillimin e muzikës në arsimin e mesëm të lartë, në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale, duke kuptuar më së miri qasjen me bazë kompetencat edhe në kurrikulën e muzikës.

Çfarë synon ky libër?

Qëllimi i këtij libri është orientimi i mësuesit/et që japin muzikë në klasën e 10- 12 të, për të përmbushur synimet e kësaj kurrikule dhe zbatimin me sukses i saj kalon nëpër tri element mjaft të rëndësishëm:

- a) planifikimin e të nxënit sipas **formateve të reja**,
- b) zbatimin e metodologjinë e mësimdhënies, bazuar në **situata të nxëni**,
- c) realizimin e **vlerësimit** për të nxënë dhe i të nxënit.

Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e klasës së 10-12 të, përkatësisht shkalla e pestë e lëndës Muzikë, miratuar nga MAS-i, në dhjetor 2015.

Ky libër merr përsipër:

- ***të sqarojë*** çdo mësues të muzikës për të gjitha çështjet e planifikimit, metodologjisë dhe vlerësimit, që duhet të zbatojë çdo mësues në lëndën e tij.
- ***të udhëheqë*** çdo mësues me (3) formatet e planifikimit të kërkuara dhe mënyrën se si ato duhet të përdoren nga vetë mësuesi në lëndën e muzikës, duke i udhëzuar ***ata*** mbi: planifikimin *vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxënit, format e vlerësimit* etj., me të cilat duhet të punojë mësuesi gjatë një viti shkollor.

Ky libër në parim ofron modele ose i sugjeron ato por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me *planifikimin, situatat e të nxënit, metodologjinë apo vlerësimin*, krijohet mbi një bazë të caktuar të realitetit dhe nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim.

Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

AUTORJA

Përmbajtja

Programi mësimor, kompetencat dhe kuptimi i tyre	4
Planifikimi i kurrikulës (programi i muzikës 10)	9
Planifikimi vjetor i lëndës muzikë, sipas tematikave dhe tremujorëve	10
Planifikimi tre mujor: shtator - dhjetor	12
Planifikimi i tremujorit i, shtator-dhjetor	15
Metodologjia e mësimdhënies	20
Planifikimi ditor për 3 mujorin e parë – shtator – dhjetor 6 Mësime model	22
Planifikimi i tre mujorit : janar - mars	36
Planifikimi i tremujorit ii, janar-mars	39
Planifikimi ditor për 3 mujorin ë dytë – janar – mars 5 mësime model	43
Planifikimi i tre mujorit : prill - qershor	53
Planifikimi ditor për 3 mujorin e dytë prill – qershor 5 Mësime model	67
Vlerësimi	76

PROGRAMI MËSIMOR, KOMPETENCAT DHE KUPTIMI I TYRE

Kjo libër përshkruan në mënyrë të detajuar programin mësimor të muzikës, klasa 10-të dhe udhëheq mësuesin për ndërtimin e *kompetencave të lëndës së muzikës* si dhe të *kompetencave kyçe*, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën. Kjo lëndë vazhdon të zhvillohet në arsimin e mesëm të lartë (AML), pikërisht në shkallën e pestë ose të gjashtë.

Kompetencat kyçe dhe muzika

Fjala *kompetencë* ka filluar të zbatohet tashmë në mjediset mësimore, pikërisht në klasat 1- 2 dhe 6-7. Kompetencat shprehen nëpërmjet rezultateve të të nxënës, duke dhënë qartë rolin që ato kanë në përdorimin dhe në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave kontekstuale në të cilën zhvillohet njohuria muzikore.

Domosdoshmëria e zotërimit të kompetencave i aftëson individët / nxënësit të bëhen të aftë dhe t'i përdorin ato përgjatë gjithë jetës.

Kompetencat kyçe janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
- Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare
- Kompetenca digjitale

Çdo mësues/e duhet të dijë pse shërbejnë **7 kompetencat kyçe**, duke ditur sesi t'i zhvillojë dhe ndërtojë ato në kontekstin e lëndës së vet me nxënësit/et sipas formateve të përcaktuara. Këto kompetenca ndërtohet dhe arrihen përgjatë shkallës. Mësuesi/ja duhet të kujdeset që përveç kompetencave lëndore të muzikës, të zhvillojë domosdoshmërisht me nxënësit e tij edhe kompetencat kyçe.

Kuptimi dhe zbatimi i kompetencave lëndore dhe tematikave që zhvillohen në lëndën e Muzikës.

Qasja e bazuar në kompetenca është i gjithë procesi i të nxënit që zhvillohet në fushën e arteve në përgjithësi, në të gjitha shkallët, dhe ndërtohet përmes kompetencave të kësaj fushe **krijimit, performimit/realizimit dhe vlerësimit**. Në të gjitha shkallët e kurrikulës, ato zhvillohen dhe plotësohen më tej me **rezultate të të nxënit** brenda secilës fushë të arteve. Kompetencat lëndore të muzikës, lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me **kompetencat kyçe**. Këto kompetenca janë të lidhura ngushtë me tematikat e lëndës së muzikës dhe zhvillohen nëpërmjet tyre.

Përvetësimi i njohurive muzikore nënkupton *zotërimin e kompetencave muzikore*. Në këto kushte, **zotërimi i kompetencave muzikore** do të thotë aftësia për të kuptuar, gjykuar përdorur muzikën në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh jo vetëm brenda kontekstit të programit mësimor dhe kërkesave të tij por edhe në situata në të cilën muzika luan ose mund të luajë një rol të rëndësishëm.

Me kurrikulën e re, muzika është strukturuar me tre (3) tematika përmbajtësore dhe (3) kompetenca, të cilat listohen si më poshtë:

TEMATIKAT E MUZIKËS ¹	KOMPETENCAT E MUZIKËS
<i>Tematika 1:</i> Gjuha dhe komunikimi muzikor.	Kompetenca 1: Krijimi muzikor.
<i>Tematika 2:</i> Teknika dhe procese muzikore.	Kompetenca 2: Performimi/interpretimi muzikor.
<i>Tematika 3:</i> Historia, muzika dhe shoqëria.	Kompetenca 3: Vlerësimi i veprave muzikore.

Kompetenca 1: Krijimi muzikor, ka të bëjë me përdorimin e ideve të ndryshme për të organizuar krijimin muzikor, përdorimin e elementeve muzikore gjatë krijimit, zhvillimin e ideve të reja gjatë krijimit dhe organizimin e krijimit sipas strukturës muzikore, duke ndarë përvojat e veta krijuese me të tjerët.

Kompetenca 2: Performimi/interpretimi muzikor, ka të bëjë me kuptimin dhe zbatimin e teknikave të këndimit, interpretimit, deri në perfeksionimin e saj, dhe ndarjen e përvojave të veta performuese me të tjerë.

Kompetenca 3: Vlerësimi muzikor, ka të bëjë me kuptimin dhe analizimin e veprave muzikore që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.

¹ Secila tematikë e lëndës së muzikës, duhet të realizojë të tre (3) kompetencat lëndore

PLANIFIKIMI I KURRIKULËS (PROGRAMI I MUZIKËS 10)

Planifikimi i kurrikulës dhe, pra i përmbajtjes së programit, është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit që zgjat gjithë vitin shkollor. Përgatitja e dokumenteve që shoqërojnë punën e tij përgjatë vitit janë të shumta dhe kanë të bëjnë me *planifikimin* dhe *dokumentet* përkatëse që e shoqërojnë atë. Planifikimi i dokumenteve nga mësuesi/ sja kërkon: kreativitet, liri, fleksibilitet dhe përgjegjshmëri në planifikim. Këto dokumente janë:

1. Planifikimi vjetor i lëndës Muzikë, sipas 3 mujorëve
2. Planifikimi 3 mujor (temat janë të ndërthura sipas tematikave)
3. Planifikimi ditor

Të tri planifikimet, bëhen bazuar në ndarjen e kohës mësimore që sugjeron programi mësimor i muzikës dhënë në tabelën e mëposhtme:

Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Lënda e muzikës zhvillohet në kurrikulën me zgjedhje të detyruar në klasën X, XI, ose XII, në 36 javë mësimore me nga 2 orë në javë, pra gjithsej 72 orë. Programi i lëndës së muzikës specifikon peshën (orët e sugjeruara) të secilës tematikë, ku shumica e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore të përcaktuara në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

Tabela 1: Kohëzgjatja dhe orë të sugjeruara për çdo tematikë

Tematikat	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknikat dhe proceset	Historia, muzika dhe shoqëria	Gjithsej
Klasa e 10-të/11-të ose 12-të	15	30	27	72 orë

PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS MUZIKË, SIPAS TEMATIKAVE DHE TREMUJORËVE

SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE		
Shtator – Dhjetor 24 orë	Janar – Mars 24 orë	Prill – Qershor 24 orë
Gjuha dhe komunikimi muzikor (15 orë)	Teknika dhe procese (30 orë)	Historia, muzika dhe shoqëria (27 orë)
1.1. 1.1. Muzika dhe kultura e popujve	2.1. Koralja “Ave Maria” J. S. BACH	3.1. Muzika në mesjetën e lulëzuar (shek. XI – XV)
1.2. Muzika dhe lufta	2.2. Përsëritje e koralet	3.2. Kultura muzikore gjatë Rilindjes
		3.3. Shkollat polifonike
		3.4. Kultura muzikore në Evropë gjatë periudhës së barokut
1.2. 1.3. Muzika dhe puna	2.3. Kënga “Lule bore” S. Gjoni	3.5. Kompozitorët gjatë periudhës së barokut J. S. Bach dhe ZH. F. Hendel
1.3. 1.4. Muzika dhe shëndeti	2.4. Përsëritje e këngës	3.6. Kultura muzikore gjatë periudhës së klasicizmit
1.5. Muzika dhe ju - përmbledhje	2.5. “Në qetësinë e natës” J. Brahms	3.7. Kompozitorët në klasicizëm Hajden, Mozart, Beethoven
1.6. Muzika dhe sporti	2.6. Përsëritje e këngës	3.8. Dëgjime muzikore dhe reflektime
1.7. Muzika dhe kërcimi	2.7. “Moj e bukura More” R. Dhomi	3.9. Kultura muzikore në Evropë gjatë periudhës së romantizmit
1.8. Muzika e filmit dhe e reklamave	2.8. Përsëritje e këngëve	3.10. Kompozitorët F. Schubert, F. Chopin, F. Liszt
1.9. Muzika dhe ju - përmbledhje	2.9. Koralja “Oda e gëzimit” L. V. Beethoven	3.11. Kompozitorët gjatë periudhës së romantizmit, muzika vokale
1.10. Struktura muzikore	2.10. Përsëritje e këngëve	3.12. Dëgjime muzikore dhe reflektime
1.11. Format muzikore	2.11. Përsëritje e këngëve	3.13. Muzika gjatë shekullit XX
1.12. Format 1-2-3-pjesëshe	2.12. Përsëritje e këngëve	3.14. Muzika modern
1.14. Muzika dhe ju - përmbledhje	2.13. Përsëritje e këngëve	3.15. Muzika shqiptare në lashtësi dhe mesjetë

1.15. Përdorni njohuritë tuaja	2.14. Përsëritje e këngëve	3.16. Muzika në periudhën e rilindjes
1.16. Zëri instrumenti ynë natyror	2.15. Përsëritje e këngëve	3.17. Përfaqësues të muzikës shqiptare në gjysmën e parë të shek. XX
1.17. Rregullat e këndimit	2.16. Përsëritje e këngëve	3.18. Dëgjime muzikore dhe reflektime
1.18. Këndimi dhe formacionet vokale	2.17. Përsëritje e këngëve	3.19. Muzika profesioniste shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX
1.19. Këngë të rrymave të ndryshme muzikore - Elvis Presli	2.18. Përsëritje e këngëve	3.20. Muzika profesioniste kosovare
1.20. Grupi Bitëllsat "Imagine"	2.19. Përsëritje e këngëve	3.21. Muzika vokale profesioniste shqiptare
1.21. Këngëtarët shqiptarë	2.20. Muzika në Mesopotami, Egjipt, Indi dhe Kinë	3.22. Muzika e lehtë shqiptare
1.22. Përsëritje e këngëve	2.21. Muzika në Greqinë dhe Romën e lashtë	3.23. Dëgjime muzikore dhe reflektime
1.23. Projekte individuale dhe në grup	2.22. Muzika në mesjetën e hershme	3.24. TEST NJOHURISH
1.24. A)SHFAQJE KONCERTORE OSE B)DETYRË PËRMBLEDHËSE	2.23. Dëgjime muzikore dhe reflektime	
	2.20. SHFAQJE MUZIKORE	
24 orë	24 orë	24 orë
Shënim: <ol style="list-style-type: none"> 1. Tematika I "Gjuha dhe komunikimi muzikor" zhvillohet deri tek tema mësimore 1.15. pasi kjo tematikë ka 15 orë në total. 2. Më pas fillon tematika e dytë, e cila në tremujori e parë zhvillohet në 8 orë. 3. Tematika II "Teknika dhe procese" vazhdon me këngët dhe koralet zhvillohen një ose dyorëshe. Po në këtë tremujor fillojnë tema mësimore të tematikës III "Histori , muzika dhe shoqëria". 4. Çdo ngjyrë përcakton temat e një tematike. Në total tremujori duhet të përmbajë 24 orë. 5. Kujdes! Ky planifikim është vetëm sugjerues dhe jo detyrues. 		

PLANIFIKIMI TRE MUJOR: SHTATOR - DHJETOR

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi:

- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë muzikore të përjetimit, dëgjimit dhe analizimit të veprave muzikore;
- gjykon në mënyrë kritike dhe të drejtë mesazhin muzikor të veprës;
- shprehet qartë dhe komunikon saktë estetikisht dhe artistikisht për vepra të ndryshme muzikore;
- komunikon dhe shprehet nëpërmjet mjeteve shprehëse muzikore në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.

2. Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

- përpunon njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;
- zgjidh probleme të ndryshme që lidhen me muzikën apo artin, në jetën e përditshme apo në klasë/shkollë;
- zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese gjatë dëgjimit të një veprë muzikore;
- ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim, projekt apo veprimtari muzikore artistike.

3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi :

- vendos njohuritë muzikore në funksion të realizimit të një argumenti, krijimi apo projekti muzikor/artistik;
- përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një punë të vetën mbi artin në përgjithësi apo muzikën në veçanti;
- zhvillon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni.

4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi :

- zhvillon aftësitë menaxhuese artistike lidhur me një projekt artistik/muzikor;
- drejton aktivitetet muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese;
- inicion aktivitetet ndërgjegjëse ndaj ruajtjes së mjedisit, nga zhurmat akustike.

5. Kompetenca personale

Nxënësi :

- krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërmerr gjatë veprimtarive muzikore/artistike;
- merr pjesë dhe kontribuon në mënyrë aktive në jetën artistike shkollë dhe komunitet;

- zhvillon vetëbesimin tek aftësitë e veta dhe krijon lirshmëri dhe besim tek të tjerët në realizimin e detyrave artistike.

6. Kompetenca qytetare

Nxënësi :

- promovon me qytetari, vlerat të ndryshme kulturore dhe muzikore të vendit apo të krahinës;
- respekton punën dhe mendimin e të tjerëve lidhur me çështje artistike /muzikore;
- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

7. Kompetenca digjitale

Nxënësi :

- shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet lidhur aspekte të ndryshme kulturore/muzikore;
- përdor një mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave lëndore		
Krijimi muzikor	Performimi/interpretimi muzikor	Vlerësimi muzikor
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përdor ide të ndryshme për të organizuar mendimin e tij personal estetik muzikor; - zhvillon mendimin e tij personal mbi elementet muzikor gjatë analizimit të veprës muzikore; - shpreh përjetimet dhe përfytyrimet muzikore gjatë dëgjimit muzikor; - organizon bindjet e veta për të shprehur mesazhin e veprës muzikore; - ndan përvojat e veta muzikore me të tjerët. 	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përjeton emocionalisht gjatë procesit të këndimit, vepra të ndryshme (këngë, kanone, këngë popullore, arie etj.), duke zhvilluar një kuptim të qartë të këndimit në grup; - përjeton emocionalisht gjatë procesit të dëgjimit, vepra të ndryshme muzikore (vokale apo instrumentale), duke zhvilluar një kuptim të qartë të veprës muzikore; - këndon motivet apo temat mjaft të njohura të pjesëve muzikore apo melodive të përzgjedhura (rinjohje nëpërmjet fishkëllimit apo këndimit të temave kryesore); 	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - zhvillon gjykimin e vet muzikor dhe estetik mbi veprat të ndryshme muzikore; - analizon veprat muzikore (vokale dhe instrumentale) që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë duke u mbështetur veçoritë e veprave muzikore; - bën krahasimin e veprave muzikore, duke u shprehur me një gjuhë të qartë muzikore dhe përdorur terminologji si: melodi, ritëm, harmoni, formë etj.;

	<ul style="list-style-type: none">- interpreton mendimin e vet mbi përmbajtjet muzikore të pjesëve të parapëlqyera përmes komunikimit artistik dhe estetik të saj (ese-ja);- ndan përvojat e veta performuese/interpretuese me të tjerë.	<ul style="list-style-type: none">- vlerëson veprat muzikore, sipas llojit, autorit, vendit dhe periudhës historike në të cilën është realizuar vepra, duke ndërtuar një gjykim kritik dhe estetik.
--	---	---

PLANIFIKIMI I TREMUJORIT I, SHTATOR-DHIJTOR ² ,			
Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënës
1.	Gjuha dhe komunikimi muziko	Muzika dhe kultura e popujve	<p>Situata e të nxënës: Të përbashkëta dhe të ndryshme</p> <p>Vendosen disa foto nga popuj të ndryshëm që paraqesin kulturën e tyre në veshje, në kërcime, gjatë ceremonive të ndryshme dhe nxiten nxënësit të flasin rreth kulturave që ata njohin më mirë.</p>
2.		Muzika dhe lufta	<p>Situata e të nxënës: Muzika dhe lufta</p> <p>Vendosen disa foto nga filmi artistik “Pianisti” i regjisorit Roman Polanski, ose fragmente pikante nga ky film në DVD (nëse ekzistojnë pajisjet). Nxiten nxënësit të flasin rreth tematikës që trajton ky film. Etj.....</p>
3		Muzika dhe puna	<p>Situata e të nxënës: Përjetim dhe diskutim</p> <p>Vendoset një muzikë në sfond dhe diskutohet rreth ndikimit që krijon muzika gjatë momenteve kur ne studiojmë apo jemi duke bërë ndonjë punë. Çfarë ndodh? A ndihmon apo pengon muzika gjatë punëve që bëjmë?</p>
4.		Muzika dhe shëndeti	<p>Situata e të nxënës: Efekti Moxart</p> <p>Vendosen disa fragmente muzikore për dëgjim, dhe nxënësit dëgjojnë me sy mbyllur. Nxiten të flasin rreth asaj që ata ndjejnë. A ndikon muzika në momente të caktuara kur janë: mërzitur, të gëzuar të trishtuar?</p>
			<p>Burimet</p> <p>- teksti i nxënësit;</p> <p>- materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi;</p> <p>- figura / foto;</p> <p>- CD/DVD.</p>
			<p>- teksti i nxënësit;</p> <p>- materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi;</p> <p>- figura / foto;</p> <p>- CD/DVD.</p>
			<p>- teksti i nxënësit;</p> <p>- materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi;</p> <p>- figura / foto;</p> <p>- CD/DVD.</p>
			<p>- teksti i nxënësit;</p> <p>- materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi;</p> <p>- figura / foto;</p> <p>- CD/DVD.</p>

2 Të nderuar kolegë, përfundimi i tremujorit të parë llogaritet kur keni plotësuar 12 tema/javë mësimore.

PLANIFIKIMI I TREMUJORIT I, SHTATOR-DHJETOR ² ,				
Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënës	Burimet
5.		Muzika dhe ju - përmbledhje		
6.		Muzika dhe sporti	Situata e të nxënës: Sporti im i preferuar Duke vëzhguar foto nga sporte të ndryshme diskutohet rreth muzikës që i shoqëron këto lloj sportesh. Pse muzika është një element i rëndësishëm në zhvillimin e këtyre sporteve? Cila muzikë i shoqëron kryesisht këto lloj sporte?	- teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshatura nga mësuesi; - figura / foto; - CD/DVD.
7.		Muzika dhe kërcimi	Situata e të nxënës: Kërcimi im i preferuar Vendosen disa përkufizime dhe diskutohet rreth tyre: “Kompleks lëvizjesh ritmike të trupit” “Bashkësi gjestesh dhe hapsh që i nënshtrohen një ritmi të caktuar” “Bashkësi lëvizjesh dhe hapsh të njëpasnjëshme....” Çfarë ku kujton filmi “Step up revolution”?	- teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshatura nga mësuesi; - figura / foto; - CD/DVD.
8.		Muzika e filmit dhe e reklamave	Situata e të nxënës: Filmi dhe muzika Vendoset në CD /DVD kolona muzikore e filmit të EnioMorrikone-s? Nxiten nxënës të flasin rreth kësaj muzike? Sa rëndësi ka muzika në vlerësimin e një filmi artistik? Cila është kolona zanore juaj e preferuar?	- teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshatura nga mësuesi; - figura / foto, - CD/DVD.
9		Muzika dhe ju - përmbledhje	Situata e të nxënës:	

PLANIFIKIMI I TREMUJORIT I, SHATA TOR-DHJETOR ² ,				
Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënës	Burimet
10		Struktura muzikore	Situata e të nxënës: Poezia dhe muzika Recitohet një poezi dhe përcaktohet ritmi dhe motive i poezisë. Më pas merret një këngë dhe përcaktohet ritmi dhe motive i saj. Pra ritmi dhe motivi janë dy elemente të përbashkëta si në muzikë ashtu dhe poezi.	- teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura / foto; - CD/DVD.
11		Format muzikore	Situata e të nxënës: Format me sy të lirë Vëzhgohen disa foto që tregojnë qartë strukturën arkitektonike të ndërtesave. Nxënësit përcaktojnë pjesët përbërëse të tyre. Po muzika ka formë? Përbëhet nga 1 pjesë apo disa?	- teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura / foto; - CD/DVD.
12		Format 1-2-3-pjesëshe	Situata e të nxënës: Format në art dhe format në muzikë Vëndoset një pjesë në CD dhe gjenden disa karakteristika të pjesës muzikore. Më pas vëzhgohen disa foto nga veprat e Kandinskit ku flitet për llojet e formave të përdorura në artin e tij.	- teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura / foto; - CD/DVD.
13		Muzika dhe ju (përmbledhje)		- teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi.
14		Përdorni njohuritë tuaja	Minikuic mbi njohuritë e marra	- teksti i nxënësit
15	Teknika dhe procese	Zëri instrumenti ynë natyror	Situata e të nxënës: Karakteristikat e zërit Nxënësit dëgjojnë në CD disa fragmente nga arie të ndryshme dhe përcaktojnë llojet e zërave që dëgjojnë: burrë, grua, vajzë, djallë etj.	- teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura / foto - CD/DVD.

PLANIFIKIMI I TREMUJORIT I, SHTATOR-DHIJETOR ² ,				
Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënës	Burimet
16		Rregullat e këndimit		- teksti i nxënësit; - CD/DVD.
17		Këndimi dhe formacionet vokale	Situata e të nxënës: Këndimi vetëm dhe në grup Nxënësit vendosen të këndojnë 1 person, pastaj 2 persona bashkë, 3 persona, 4 e me radhë deri në 8 persona. A dinë ata t'i emërtojnë ndryshe të kënduarit bashkë?	- teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshatura nga mësuesi; figura / foto; - CD/DVD.
18		Këngë të rrymave të ndryshme muzikore - Elvis Presly	Situatë e të nxënës: Disa fakte nga jeta e Elvis Preslit Nxënësit u kërkohet të thonë disa fakte që dinë mbi mbretin e muzikës rok dhe ti rendisin ato në dërrasë të zezë. Më pas këndojnë këngë nga repertori i tij.	- materiale të përgatitura nga mësuesi; - materiale të përgatitura nga nxënësit; - foto; - DVD ose interneti.
19		Grupi Bitëllsat "Imagine"	Situatë e të nxënës: Grupi im i parapëlqyer shqiptar ose i huaj Vendosen disa fragmente këngësh nga grupet e njohura shqiptare apo të huaja. Cilat janë karakteristikat e një grupi muzikor? Çfarë kanë të përbashkët apo specifike?	- materiale të përgatitura nga mësuesi; - materiale të përgatitura nga nxënësit; - foto; - DVD ose interneti.
20		Këngëtarët shqiptarë		- materiale të përgatitura nga mësuesi; - materiale të përgatitura nga nxënësit; - foto; - DVD ose interneti.
21		Përsëritje e këngëve		- materiale të përgatitura nga mësuesi; - materiale të përgatitura nga nxënësit; - foto; - DVD ose interneti.

PLANIFIKIMI I TREMUJORIT I, SHTATOR-DHJETOR ² ,				
Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Burimet
22		Projekte individuale dhe në grup	Kërkim individual rreth një këngëtari apo grupi mjaft të njohur shqiptar /huaj.	- Interneti; - Wikipedia; - materiale të ndryshme buimore; - Foto/CD.
23		A)SHFAQJE KONCERTORE B)DETYRË PËRMBLEDHËSE	Muzika dhe të rinjtë U kërkohet nxënësve të hartojnë me shokët/ qet pyetjet që do t'u bëhen të intervistuarve. Kryejnë me shokët/ qet intervista në komunitet rreth llojit muzikor që pëlqejnë më shumë. Analizojnë me shokët/ shoqet përgjigjet e marra, duke përcaktuar muzikën e parapëlqyer (1 deri në 2 lloje).	
Metodologjia				
Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse.				
Puna në grup dhe puna individuale.				
Hetimi dhe zbulimi.				
Zbatime praktike Brenda dhe jashtë klase. Metoda integrale.				
Bashkëbisedim për tema të caktuara.				
Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues.				
Prezantime në forma të ndryshme, përmes Teknologjisë.				
Projekte individuale dhe në grup.				
Shfaqje përmbyllëse ose detyra përmbyllëse (përfundimi me sukses i arritjeve)				
Vlerësimi:				
- vlerësimi përshkrues;				
- vlerësimi i tematikave përmbyllëse;				
vlerësimi i dosjes.				

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

4. Metodologjia e të nxënit dhe mësimdhënies bazuar në kompetenca për lëndën e muzikës

4.1. Planifikimi i situatave të të nxënit - Planifikimi ditor

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënit të muzikës është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor/artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të muzikës, do të thotë që nxënësit/et të vendosen në situata konkrete krijuese, ku ata përjetojnë dhe provojnë vetë gjatë proceseve muzikore. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet motivimit dhe përkundrejt zhvillimit të kompetencave të caktuara si dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e muzikës, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari krijuese, shprehëse, emocionale. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore muzikore është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt saj në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit intelektual/krijues dhe artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia e muzikës, synon gjithëpërfshirjen dhe bazohet:

në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca;

mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe

mësimdhënien e nxënien e integruar.

Nxënësit/et e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës sesi ata/ato nxënë: *individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete* etj. Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e muzikës mban parasysh:

- **ndërtimin** e kompetencave kryesore të të nxënit në muzikë;
- **lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale** të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- **formimin dhe forcimin** aftësive dhe shprehive muzikore;
- **zbatimin** e veprimtarive krijuese/interpretuese/vlerësuese muzikore, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet muzikore me situata të jetës reale;

- **përdorimin** e mjeteve muzikore konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë CD, DVD, kompjuter, magnetofon;
- **nevojën e individit** për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- **zhvillimin e qëndrimit pozitiv** ndaj lëndës së muzikës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- **nxitjen e bashkëveprimit** mësues-nxënës që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi të jenë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie planifikuar mirë, krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Planifikimi i mirë i përmbajtjes dhe ndërtimi i kompetencave muzikore të përcaktuara në këtë program janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet *situatave të të nxënësit*. *Situata e të nxënësit* për secilin model të planifikimit ditor, është sugjeruese, sepse kërkon të nxisë dhe orientojë mësuesit rreth zhvillimit të orës mësimore. Niveli i nxënësve, burimet materiale, përvoja e vetë mësuesit, mjetet në dispozicion për realizimin orës mësimore, dhe për këtë arsye vendosja e rezultateve të të nxënësit për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe lëndore nuk mund të jenë për të gjithë njësoj. Kështu që çdo mësues zgjedh të zhvillojë sipas këtij modeli të sugjeruar, por mund të zhvillojë këtë situatë apo të zhvillojë temën mësimore në një situatë tipike për klasën e tij. Ato kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve përmes njohurive që ata kanë. Nxënësit/et janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, krijime ose simulime të njohurive, interpretimeve/performimeve, gjykimeve dhe qëndrimeve artistike. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi/sja duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në muzikë.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësit/et të punojnë me situata dhe veprimtari reale që ata i njohin, ku i kërkojnë arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si: “Pse shërben muzika në jetën e përditshme?”, “A ndihmon muzika në përmirësimin e emocioneve tona?”, “Kush është kënga/rryma ime e preferuar?”, “Cilat janë pjesët muzikore të preferuara dhe kompozitori im i dashur?”, “Çfarë di për jetën dhe veprën e tij” etj. Në këtë mënyrë ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e veta dhe të zhvillojë situata të reja në kontekste të caktuara.

Detyrat përmbledhëse/shfaqjet muzikore, esetë, projektet individuale dhe në grup, kërkimet mbi çështje të ndryshme, gjykimet dhe qëndrimet personale janë një tjetër mënyrë që i krijon nxënësit mundësinë të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron, si dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integruese me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj.

Prezantimet e punimeve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë

mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave muzikore/artistike, por edhe të gjitha të kompetencave kyçe.

Shënim: Gjatë planifikimeve tremujore:

1. Jo gjithmonë bëhet që në fillim planifikimi i situatave të të nxënit.
2. Ato mund të parashikohen edhe në planifikimin ditor të temës mësimore.
3. Ndodh që situatat e të nxënit mund të mos shkruhen si në rastin e përsëritjeve të këngës ose të ndonjë teme shumë specifike.

PLANIFIKIMI DITOR PËR 3 MUJORIN E PARË - SHTATOR - DHJETOR 6 MËSIMI MODEL³

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12 ³
Tematika: Gjuha dhe komunikimi Tema mësimore: “Muzika dhe lufta”		Situata e të nxënës: Muzika dhe lufta Vendosen disa foto nga filmi artistik “Pianisti” i regjisorit Roman Polanski, ose fragmente pikante nga ky film në DVD (nëse ekzistojnë pajisjet). Nxiten nxënësit të flasin rreth tematikës që trajton ky film. Pse muzika është pjesë shumë e fortë e njeriut edhe në momentet më të vështira? A dinë raste të tjera ku muzika është bërë mbështetëse për njerëzit në periudha të vështira ashtu sikurse Lufta II Botërore? Nxënësit diskutojnë dhe rendisin fakte, argument dhe gjykime të qëndrueshme duke reflektuar mbi njohuritë e mara për të kuptuar rolin dhe rëndësinë e muzikës në luftë.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan rolin dhe rëndësinë që ka muzika për të komunikuar në periudha të ndryshme; - kupton rolin e disa instrumenteve muzikore gjatë luftërave në periudha të ndryshme historike; - shpjegon rolin e instrumenteve në luftë; - ndërton dhe argumenton me raste reale se si ndikon muzika në moment të vështira të jetës njerëzore. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - brirët; - tamburet; - trumbetat; - këngë partizane; - big band. 	

³ Muzika, mund të zhvillohet në klasë të 10, 11 apo 12, në varësi të zgjedhjes që bëhet nga nxënësit dhe shkolla. Ndaj te rubrika e shkallës dhe e klasës vendoset me ndarje p.sh.: Klasa 1-/12 dhe shkalla V/VI.

Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - shembuj muzikore të parapërgatitura në CD; - fragmente kryesore nga filmat e rekomanduar në tekst (DVD). 	Lidhja me lëndët e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - letërsia; - historia.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p> <p>Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos disa foto apo fragmente (DVD) nga filmi “Pianisti” i regjisorit Roman Polanski.</p> <p>Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth fotove apo pamjeve që shikojnë nga filmi i cili pasqyron marrëdhënien dhe rolin e muzikës në kohë lufte. Ata ngrenë çështje, argumentojnë, shpjegojnë apo reflektojnë për ngjarje, instrumente apo fakte reale analoge me atë të filmit “Pianisti”.</p> <p>Hapi II: foto apo fragmente (DVD) “Gëzuar krishtlindjet” i regjisorit Kristian Karion (Christian Carion).</p> <p>Hapi III: ndërkohë shpjegohet pak <i>si</i> dhe <i>pse</i> muzika ka shoqëruar luftërat që në kohët e lashta. Gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, muzika kishte një funksion shumë të rëndësishëm. Në Itali lindën këngë popullore që tregonin për vuajtje dhe padrejtësi ose që rikujtonin me nostalgji jetën larg frontit të luftës. Shumë vende që ishin në luftë dërgonin artistët e tyre në kampet ushtarake, për të ngritur dhe mbajtur lart moralin e ushtarëve.</p> <p>Xhazi në luftë është një lloj muzike u luajt shpesh në zonat që ishin fronte lufte gjatë Luftës së Dytë Botërore, për të larguar vëmendjen e ushtarëve nga betejat. Edhe në Shqipëri gjatë dy luftërave botërore u krijuan këngë patriotike dhe më pas këngët partizane që pasqyronin idealet e kohës në të cilën u krijuan. Këto ishin kërkesat dhe idealet që kishin popujt e Evropës, gjatë kësaj periudhe.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me hapi IV, ku mësuesi vendos në CD këngë të ndryshme partizane. Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht rreth asaj: - - çka dinë rreth këngëve partizane; - - çfarë përfaqësonin ato për kohën. - - nga kush këndoheshin? <p>Hapi V : Duke dëgjuar muzikë të viteve 1900 -1944, nxënësit drejtohen të gjejnë ndryshimet ose të përbashkëtat e muzikës që dëgjojnë si dhe diskutojnë me njëri - tjetrin duke ballafaquar njohuritë që kanë dhe për qëllimin në të cilën u krijuan këto këngë.</p> <p>Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në <i>youtube</i> apo <i>internet</i>, këngë apo muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.</p>	

Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- - përshkrimin rolit dhe rëndësisë që ka muzika për të komunikuar në periudha të ndryshme;
- - shpjegimin e rolit e disa instrumenteve muzikore gjatë luftërave në periudha të ndryshme historike;
- - shpjegon rolin e instrumenteve në luftë;
- ndërtimin dhe argumentimin me raste reale se si ndikon muzika në moment të vështira të jetës njerëzore;
- krijimin e mendimit krijues personal, i nxitur nga përqendrimi dhe zhvillimi i të menduarit gjatë veprimtarisë mësimore;
- - për respektimin e mendimit të mendimit të shokut/shoqes.

Detyra

Detyrë përmbledhëse: materiale dhe të dhëna mbi veprën muzikore Oratorio për kor dhe orkestër “Një i mbijetuar i Varshavës” të kompozitorit Arnold Shënberg (Arnold Schönberg). Punë në grupe.

Ese: Mbresat rreth kësaj veprës muzikore oratorio për kor dhe orkestër “Një i mbijetuar i Varshavës” të kompozitorit Arnold Shënberg. Punë individuale.

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12
Tematika: Gjuha dhe komunikimi Tema mësimore: “Muzika dhe sporti”		Situata e të nxënës: Sporti im i preferuar Duke vëzhguar foto nga sporte të ndryshme diskutohet rreth muzikës që i shoqëron këto lloj sportesh. Pse muzika është një element i rëndësishëm në zhvillimin e këtyre sporteve? Cila muzikë i shoqëron kryesisht këto lloj sporte?	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - - përshkruan rolin dhe rëndësinë që ka muzika në zhvillimin e sporteve të ndryshme; - - shpjegon rolin e muzikës në ekzekutimin e sporteve të ndryshme artistike; 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - - sporti; - - trombë; - - daullja; - - ritme muzikore; - - not i sinkronizuar; - - balet në akull. 	

<ul style="list-style-type: none"> - - përgatit materiale me rolin dhe funksionin e muzikës sportive të ndryshme; - përgatit DVD ose CD me muzikë për sporte të ndryshme: fitnes, patinazh etj. 	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura/foto; - CD/DVD. 	Lidhja me lëndët e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p> <p>Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos disa foto nga sporte të ndryshme ku nxiten nxënësit të diskutojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rreth sporteve dhe rreth muzikës që i shoqëron këto lloj sportesh. - Pse muzika është një element i rëndësishëm në zhvillimin e këtyre sporteve? - Cila muzikë i shoqëron kryesisht këto lloj sporte? <p>Hapi II: fragment nga kënga (CD) “<i>Ti nuk do të ecësh kurrë vetëm</i>” (You will never walk alone) këngë, e cila këndohet nga tifozët anglezë. Diskutohet rreth saj.</p> <p>Hapi III: ndërkohë shpjegohet <i>pse</i> në një veprimtari sportive përzgjedhja e duhur muzikore ndikon në përjetimin dhe praktikimin më të mirë të disiplinës sportive.</p> <p>Sporti sot praktikohet nga një numër shumë i madh njerëzish dhe është forma më popullore e argëtimit dhe jo vetëm, nëpër botë. Muzika në të ka funksione të ndryshme. Atë e gjejmë në këngët dhe tingujt e krijuar nga tifozët e skuadrave të futbollit. Këndimi i <u>tyre</u> i jep kurajë dhe i shton pozitivitetin skuadrës së zemrës dhe shkakton të kundërtën për skuadrën tjetër.</p> <p>Në manifestimet e mëdha e të përbashkëta, si në Lojërat Olimpike ose në kampionatet botërore, muzika kërkon të japë idenë e solidarizimit të sporteve dhe të njerëzve.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me <i>hapi IV</i>, ku mësuesi vendos në DVD momente filmike me pamje dhe muzikë që paraqesin patinazh artistik apo not të sinkronizuar. Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtime rreth tyre: - çka dinë rreth notit të sinkronizuar. - çfarë dinë për patinazhin artistik? 	

Hapi V: Organizoni një ecje sportive së bashku. Diskutoni me njëri-tjetrin dhe vendosni së bashku për muzikën që do të zgjidhni për të dëgjuar në kufje. Mbani parasysh që muzika e zgjedhur duhet t'ju ndihmojë për të mbajtur një ritëm të qëndrueshëm dhe energjik. Mos harroni që gjatë diskutimit të respektoni sugjerimet e secilit dhe që në fund të gjithë të jenë të kënaqur nga zgjedhja muzikore dhe në vijim nga e gjithë veprimtaria.

Diskutoni së bashku pastaj në klasë për çka përjetuat, mbi çka dinit dhe çka mësuat.

-

- Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në *youtube* apo *internet*, muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.

Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- - përshkrimin e rolit dhe rëndësisë që ka muzika në zhvillimin e sporteve të ndryshme;
- - shpjegimit të rolit të muzikës në ekzekutimin e sporteve të ndryshme artistike;
- - përgatitjen e DVD ose CD me muzikë për sporte të ndryshme: fitnes, patinazh etj.;
- krijimin e mendimit krijues personal, i nxitur nga përqendrimi dhe zhvillimi i të menduarit gjatë dëgjimit muzikor;
- - respektimin e mendimit të mendimit të shokut/shoqes.

Detyra:

Kërkim: të materialeve apo muzikë të ritmizuar që përdoret në sporte të ndryshme.

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12
Tematika: Gjuha dhe komunikimi Tema mësimore: "Muzika dhe kërcimi"		Situata e të nxënës: Kërcimi im i preferuar Vendosen disa përkufizime dhe diskutohet rreth tyre: - "Kompleks lëvizjesh ritmike të trupit" - "Bashkësi gjestesh dhe hapsh që i nënshtrohen një ritmi të caktuar" - "Bashkësi lëvizjesh dhe hapash të njëpasnjëshme..."	

	<p>- Çfarë ku kujton filmi “Step up revolution”?</p> <p>- A është i ndërtuar ky film mbi elemente të ndryshme të kërcimit? Cilat janë ato?</p> <p>- Imitohen disa nga lëvizjet që realizohen në këtë film.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon rolin dhe rëndësinë që ka kërcimi në jetën tonë; - argumenton arsyet pse kërcimi ka shumë rëndësi në jetën tonë; - liston lloje kërcimi moderne apo klasike. - demonstroi disa lëvizje nga kërcimi i preferuar; - flet për vepra arti ku subjekt i frymëzimit është kërcimi dhe argumenton veprën e artistit. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kërcimi; - lëvizja; - koreograf; - puantet; - pasqyra.
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - shembuj muzikore të parapërgatitura në CD; - fragmente kryesore nga filmat e rekomanduar në tekst (DVD). 	<p>Lidhja me lëndët e tjera:</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i></p> <p>Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi shkruan disa përkufizime apo kuptim të fjalës kërcim dhe diskutohet rreth tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> - “Kompleks lëvizjesh ritmike të trupit”; - “Bashkësi gjestesh dhe hapsh që i nënshtrohen një ritmi të caktuar”; - “Bashkësi lëvizjesh dhe hapash të njëpasnjëshme...”. <p>Hapi II: Vendoset fragmente (DVD) kërcime dasme haka.</p> <p>Hapi II: vendoset fragmente (DVD) nga filmi “Step up revolution” i regjisorit Skot Spir (Scott Spear).</p>	

Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth këtij filmi:

- Çfarë ku kujton filmi “*Step up revolution*”?
- A është i ndërtuar ky film mbi elemente të ndryshme të kërcimit?
- Cilat janë ato?
- Imitohen disa nga lëvizjet që realizohen në këtë film.

Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me **hapin III**, ku mësuesi shpjegon rreth zhvillimit të kërcimit nga forma instiktive e tij deri në formën më të lartë të koreografisë të baletit klasik.

Kërcimi është tërësia e lëvizjeve të trupit, që kryhen nga një ose shumë persona në të njëjtën kohë, të cilët vallëzojnë duke ndjekur muzikë instrumentale ose vokale. Origjina e kërcimeve është shumë e vjetër dhe e lidhur me ritet e hershme fetare, një nga format shprehëse më të vjetra të njerëzimit. Lidhja mistike që bashkon njerëzit e një fisi në kërcim, është një lloj lirie ku secili mund të manifestojë individualitetin e tij”.

Lëvizjet e kërcimit filluan të ktheheshin në lëvizje që krijojnë një kuptim të caktuar, që u kodifikuan dhe u formësuan në artin e **baletit**, i cili është një shfaqje, ku kërcimtarët kërcejnë lirshëm dhe shprehin emocionet mbi muzikën dhe subjektin që trajton shfaqja.

- **Hapi IV:** Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht rreth një baleti që ata kanë parë *live* ose në *Tv*:
 - - çka dinë rreth baletit;
 - - si ndërtohet një balet;
 - - përmendin disa nga baletet që ata njohin;
 - - elemente të kërcimit modern dhe baletit klasik.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- - shpjegimin e rolit dhe rëndësinë që ka kërcimi në jetën e përditshme;
- - renditjen e llojeve të kërcimit modern apo të baleteve klasike;
- - realizimin e disa lëvizjeve nga kërcimi i preferuar;
- krijimin e mendimit krijues personal, i nxitur nga përqendrimi dhe zhvillimi i të menduarit gjatë shikimit të kërcimeve të ndryshme;
- - për respektimin e mendimit të mendimit të shokut/shoqes.

Detyra:

Kërkim (Punë individuale): aktivitet fizik mund të merreni edhe në shtëpi, mjafton të dëgjoni muzikën tuaj të parapëlqyer dhe të vallëzoni së paku një orë. Në një orë kërcim shpenzohen nga 600 deri 800 kalori. Vërtetoheni këtë pohim, vetëm ose në grup. Diskutoni së bashku pas kësaj veprimtarie.

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi		Situata e të nxënësve: Filmi dhe muzika Vendoset në CD/DVD kolona muzikore e filmit të Enio Morrikones. Nxiten nxënësit të flasin rreth kësaj muzike. - Sa rëndësi ka muzika në vlerësimin e një filmi artistik? - Cila është kolona zanore juaj e preferuar? - A përcjell muzika idenë që transmeton edhe filmi? - A është Kuentin Tarantino një tjetër regjisor i kujdesshëm ndaj muzikës apo kolonës zanore të filmave të tij?	
Tema mësimore: “Muzika e filmi dhe e reklamave”			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none">- përshkruan rolin dhe rëndësinë që ka muzika në një film artistik/ dokumentar/kartonë;- veçon dhe shpjegon muzikën preferuar të një filmi artistik apo reklame;- shpjegon rëndësinë që ka elementi muzikë (kolona zanore) në marrjen e një çmimi Oskar;- mban qëndrim dhe krahason muzikë të filmave apo reklamave të ndryshëm duke bërë rolin e jurisë.		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">- - filmi dhe muzika;- - filmi dhe reklama;- - kolonë zanore.	
Burimet: <ul style="list-style-type: none">- teksti i nxënësit;- - shembuj muzikore të parapërgatitura në CD;- - fragmente kryesore nga filmat e rekomanduar në tekst (DVD).			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos fragment nga kolona zanore (CD). Vendoset në CD/DVD kolona muzikore e filmit të Enio Morrikones. Cila është kolona zanore juaj e preferuar? Nxiten nxënësit të flasin rreth kësaj muzike: <ul style="list-style-type: none">- Sa rëndësi ka muzika në vlerësimin e një filmi artistik?- A përcjell muzika idenë që transmeton edhe filmi?- A është Kuentin Tarantino një tjetër regjisor i kujdesshëm ndaj muzikës apo kolonës zanore të filmave të tij?			

Hapi II: foto apo fragmente (DVD) “*Dritat e qytetit*” ku luan aktori Çarli Çaplin.

Hapi III: ndërkohë shpjegohet mbi muzikën e filmit i cili përfshin stile e forma muzikore të ndryshme: klasike, pop, xhaz, rok, muzikë tradicionale nga vende të ndryshme etj. Interpretimi i saj vjen me forma të ndryshme, si: me orkestër, këngë të thjeshta, ansamble të vogla instrumentale, muzikë elektronike etj. Me futjen e teknologjisë digjitale, format e muzikës janë pasuruar akoma edhe më shumë. Mjaft të njohura në muzikën e filmit janë lajtmotivet (melodi ose tema muzikore të shkurtra që përsëriten shpesh gjatë filmit dhe që ngelen në vesh) dhe këngët, që krijohen për të shoqëruar një film.

Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me **hapi IV**, ku mësuesi vendos disa foto nga filmi “*Kumbari*” i regjisorit Francis Ford Coppola. Ky film doli për herë të parë në vitin 1972 dhe shënoi historinë e kinemasë botërore, apo nga filmi “*Lulëkuqet mbi mur*” duke kujtuar edhe kolonën zanore të këtyre filmave.

Hapi V: vazhdohet **më tej duke shpjeguar rreth** reklamës transmetohet nga të gjitha mjetet e komunikimit audio dhe pamore: radioja, televizioni, kinemaja dhe interneti. Muzika është një prej elementeve të saj. Fjalët e përdorura dhe emocioni që ajo krijon luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e produktit të paraqitur në reklamë. Muzika shoqëruese i përshtatet fjalëve dhe mund të jetë e lehtë, festive, solemne, trishtuese ose melankolike, në varësi të qëllimit të reklamës. Sot reklamimi është kthyer në një industri të fuqishme.

Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në *youtube* apo *internet*, muzikë në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë. Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- - shpjegimin e rolit që ka muzika në një film artistik/dokumentar/kartonë;
- - shpjegimit të muzikës së preferuar të një filmi artistik apo reklame;
- - shpjegimin e elementeve që përbëhet kolona zanore në një film;
- - qëndrimin ndaj muzikës që përfaqëson një film apo reklamë duke bërë rolin e jurisë;
- - për respektimin e mendimit të mendimit të shokut/shoqes.

Detyrë

Krijim: Krijoni në DVD reklamën e një produkti duke përfshirë të gjitha elementet e saj. Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12
Tematika: Gjuha dhe komunikimi Tema mësimore: “Format 1-2-3-pjesëshe”		Situata e të nxënit: Format në art dhe format në muzikë Vendoset një pjesë në Cd dhe gjenden disa karakteristika të pjesës muzikore. Më pas vëzhgohen disa foto nga veprat e Kandiskit ku flitet për llojet e formave të përdorura në artin e tij.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - - kupton formën 1,2,3-pjesëshe në muzikë; - - evidenton dhe përshkruan karakteristikat e formave muzikore gjatë dëgjimit; - - gjen lidhjen midis formave muzikore dhe formave në art dhe arkitekturë. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - - forma njëpjesëshe; - - forma dypjesëshe; - - forma trepjesëshe; - - kënga; - - balada; - - madrigali. 	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - - shembuj muzikore të parapërgatitura në CD. 		Lidhja me lëndët e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - -Arti pamor 	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos shembull muzikor në CD, ku nxënësit dëgjojnë me kujdes Salut d’amour, Op.12 (Elgar, Edward). Pas dëgjimit evidentohen disa karakteristika të melodisë.

Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth këtyre karakteristikave.

Hapi II: ndërkohë shpjegohet *Forma njëpjesëshe* si organizimi më i thjeshtë dhe më i vogël muzikor, ku mendimi muzikor paraqitet si një periudhë e vetme që përsëritet disa herë mbi kriterin e *përsëritjes së njëjtë*. Prej saj rrjedhin lloje të veçanta këngësh, balatesh, të ndërtuara në formën e një *strofe* (ose me disa strofa). Balata është një formë e këngës tregimtare (narrative) italiane e shek. XIII-XV dhe nuk ka të bëjë me vallen ose me emrin e formës instrumentale të viteve 1800.

Forma dypjesëshe, krijim muzikor është i përbërë nga dy melodi muzikore të ndryshme, atëherë e përcaktojmë si formë dypjesëshe. Duke u bazuar në parimin e përsëritjes së njëjtë dhe të ndryshuar të së njëjtës melodi, apo dhe të parimit të

kontrastit, materiali muzikor i nënshtrohet një ecurie logjike, e cila përfshin gjithë formën duke krijuar një të tërë. Shumë “kërcime instrumentale” të shekullit XVI-XVII janë të ndërtuara në formën dypjesëshe.

Forma trepjesëshe, struktura kompozicionale në këtë formë është e thjeshtë, pasi prezanton dy periudha kryesore A dhe B, që tani mund t’i quajmë **tema** dhe është e ndarë në tri pjesë simetrike. Në pjesën e parë A **tema** (një periudhë) mund të përsëritet dy herë, por me intensitet të ndryshëm. Në partin qendror është prezantuar një temë e re, **tema B** në kontrast me dy pjesët A, dhe në pjesën e tretë A përsëritet. Përsëritja mund të jetë njësoj ose e ndryshuar.

Matematikisht, një formë e strukturuar kështu, është trepjesëshe.

Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me **hapin III**, ku mësuesi vendos në Cd *Minuet - Luigi Boccherini - String Quintet in E Major, Op. 11 No. 5*.

- **Hapi IV**: Duke dëgjuar muzikë nxiten nxënësit të evidentojnë karakteristikat e minuetit:
 - karakteri i minuetit.
 - çfarë përfaqësonin ato për kohën.
 - motivi i minuetit.
 - instrumentet që luhet minueti.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në*:

- shpjegimin e karakteristikave të formës 1,2,3-pjesëshe në muzikë gjatë dëgjimit.
- gjetjen e lidhjeve midis formave muzikore dhe formave në art dhe arkitekturë.- ndërtimin dhe argumentimin me raste reale se si ndikon muzika në moment të vështira të jetës njerëzore.
- krijimin e mendimit krijues personal, i nxitur nga përqendrimi dhe zhvillimi i të menduarit gjatë dëgjimit muzikor.
- respektimin e mendimit të mendimit të shokut/qes.

Detyra:

Krijim (Punë individuale): Cd me pjesë muzikore; minuate, madrigale dhe këngë nga kompozitorë të ndryshëm. Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12-të
Tematika: Teknika dhe procese muzikore Tema mësimore: “Zëri instrumenti ynë natyror”		Situata e të nxëniet: Karakteristikat e zërit Nxënësit dëgjojnë në Cd disa fragmente nga arie të ndryshme dhe përcaktojnë llojet e zërave që dëgjojnë: burrë, grua, vajzë, djalë etj.	

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - - evidenton karakteristikat e zërave - vokalit; - - shpjegon llojet e zërave; - - argumenton interpretimin artistik gjatë këndimit; - - krijon CD (punë individuale) me arie nga opera të ndryshme. 	Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - - soprano; - - tenor; - - mexosoprano; - - bariton; - - bas; - - alto; - - korda; - -laringu.
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, - figura /foto; - CD/DVD. 	Lidhja me lëndët e tjera:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p> <p>Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos për nxënësit të dëgjojnë në Cd disa fragmente nga arie të ndryshme dhe përcaktojnë llojet e zërave që dëgjojnë: burrë, grua, vajzë, djalë etj.</p> <p>Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth ngjashmërive dhe ndryshimeve që i përkasin: <i>zërave apo mënyrës së këndimit</i>, duke gjykuar sipas njohurive që ata kanë.</p> <p>Hapi II: Nxënësve u kërkohet të bëjnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkrimin e karakteristikat të të kënduarit të këngëtarëve edhe pse mund të këndoje në të njëjtën gjini apo rrymë muzikore; - argumentimin e ngjashmërive apo ndryshimeve që dëgjon gjatë interpretimit të tyre. 	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me hapi III, ku mësuesi shpjegon rreth zërit dhe dëgjimit dy organeve që kryejnë dy funksione që lidhen ngushtë me njëri-tjetrin. Zëri është instrumenti më i përsosur që natyra ka krijuar te njeriu. Njëpërmjet zërit njeriu imiton çdo tingull, kurse asnjë instrument nuk mund të imitojë zërin e njeriut. Por si krijohet zëri? Zëri nxirret prej kordave vokale të cilat janë të vendosura në pjesën e sipërme të qafës, pikërisht te laringu (kanali që sjell ajrin nga goja në mushkëri). Kur thithim ajrin, kordat vokale qëndrojnë të hapura e të shtendosura. Por kur flasim ose kur këndojmë, kordat vokale tendosen, afrohen dhe gati mbyllen, duke lënë vetëm një hapësirë të ngushtë, nëpër të cilën kalon ajri, dhe shkakton dridhjen e tyre.</p>	

Pjesët përbërëse të organit të të folurit që ju shikoni në figurën në të majtë, janë pjesët që na mundësojnë të flasim dhe të këndojmë. Duke qenë se këto organet janë të ndryshme te çdo njeri, krahas fuqizimit ato i japin zërit *ngjyrë (timbër)* të veçantë për secilin prej nesh. Aq e veçantë është kjo ngjyrë sa dy njerëz nuk kanë të njëjtin timbër zëri. Nëpërmjet timbrit/ngjyrit të zërit ne bëjmë klasifikimin e zërave në

meshkuj, femra dhe fëmijë, që ndryshe cilësohen si zëra të bardhë.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura në:*

- - evidentimin e karakteristikave të zërave - vokalit;
- - shpjegimin e llojeve të zërave;
- - argumentimin e interpretimit artistik gjatë këndimit;
- krijimin e CD (punëve individuale) me arie nga opera të ndryshme;
- ndërtimin dhe argumentimin me raste reale se si ndikon muzika në moment të vështira të jetës njerëzore;
- - respektimin e mendimit të mendimit të shokut/shoqes.

Detyra:

Krijim individual: kërkim nga burime të ndryshme muzikore interpretime nga këngëtarë të ndryshëm (CD).

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

PLANIFIKIMI I TRE MUJORIT : JANAR - MARS

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi:

- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë muzikore të përjetimit, dëgjimit dhe analizimit të veprave muzikore;
- gjykon në mënyrë kritike dhe të drejtë mesazhin muzikor të veprës;
- shprehet qartë dhe komunikon saktë estetikisht dhe artistikisht për vepra të ndryshme muzikore;
- komunikon dhe shprehet nëpërmjet mjeteve shprehëse muzikore në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.

2. Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

- përpunon njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;
- zgjidh probleme të ndryshme që lidhen me muzikën apo artin, në jetën e përditshme apo në klasë/shkollë;
- zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese gjatë dëgjimit të një vepre muzikore;
- ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim, projekt apo veprimtari muzikore artistike.

3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi :

- vendos njohuritë muzikore në funksion të realizimit të një argumenti, krijimi apo projekti muzikor/artistik;
- përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një punë të vetën mbi artin në përgjithësi apo muzikën në veçanti;
- zhvillon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni.

4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi :

- zhvillon aftësitë menaxhuese artistike lidhur me një projekt artistik/muzikor;
- drejton aktivitetet muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese;
- inicion aktivitete ndërgjegjëse ndaj ruajtjes së mjedisit, nga zhurmat akustike.

5. Kompetenca personale**Nxënësi :**

- krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërmerr gjatë veprimtarive muzikore/artistike;
- merr pjesë dhe kontribuon në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;
- zhvillon vetëbesimin tek aftësitë e veta dhe krijon lirshmëri dhe besim tek të tjerët në realizimin e detyrave artistike.

6. Kompetenca qytetare**Nxënësi :**

- promovon me qytetari, vlerat të ndryshme kulturore dhe muzikore të vendit apo të krahinës;
- respekton punën dhe mendimin e të tjerëve lidhur me çështje artistike / muzikore;
- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

7. Kompetenca digjitale**Nxënësi :**

- shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet lidhur aspekte të ndryshme kulturore/ muzikore;
- përdor një mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave lëndore

Krijimi muzikor	Performimi/interpretimi muzikor	Vlerësimi muzikor
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përdor ide të ndryshme për të organizuar mendimin e tij personal estetik muzikor; - zhvillon mendimin e tij personal mbi elementet muzikor gjatë analizimit të veprës muzikore; 	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përjeton emocionalisht gjatë procesit të këndimit, vepra të ndryshme (këngë, kanone, këngë popullore, arie etj), duke zhvilluar një kuptim të qartë të këndimit në grup; - përjeton emocionalisht gjatë procesit të dëgjimit, vepra të ndryshme muzikore (vokale apo instrumentale), duke zhvilluar një kuptim të qartë të veprës muzikore; 	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - zhvillon gjykimin e vet muzikor dhe estetik mbi veprat të ndryshme muzikore; - analizon veprat muzikore (vokale dhe instrumentale) që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë duke u mbështetur veçoritë e veprave muzikore;

<ul style="list-style-type: none"> - shpreh përjetimet dhe përfitimet muzikore gjatë dëgjimit muzikor; - organizon bindjet e veta për të shprehur mesazhin e veprës muzikore; - ndan përvojat e veta muzikore me të tjerët. 	<ul style="list-style-type: none"> - këndon motivet apo temat mjaft të njohura të pjesëve muzikore apo melodive të përzgjedhura (rinjohje nëpërmjet fishkëllimit apo këndimit të temave kryesore); - interpreton mendimin e vet mbi përmbajtjet muzikore të pjesëve të parapëlqyera përmes komunikimit artistik dhe estetik të saj (ese-ja); - ndan përvojat e veta performuese/interpretuese me të tjerë. 	<ul style="list-style-type: none"> - bën krahasimin e veprave muzikore, duke u shprehur me një gjuhë të qartë muzikore dhe përdorur terminologji si: melodi, ritëm, harmoni, formë etj.; - vlerëson veprat muzikore, sipas llojit, autorit, vendit dhe periudhës historike në të cilën është realizuar vepra, duke ndërtuar një gjykim kritik dhe estetik.
--	---	--

PLANIFIKIMI I TREMUJORIT IL, JANAR-MARS ⁴ ,			
Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situatae parashikuar e të nxënës
1.	Teknika dhe procese muzikore	2.1. Koralja "Ave Maria" J. S. Bah	Situata e të nxënës: Murgesha gazmore Rikujtohet ky film me nxënësit ose shikohen fragmente nga ky film. Çfarë lloj këngësh këndonin murgeshat? Ku i këndonin ato? A duhet të kishin një formim vokal që të këndonin ato?
2.		2.2. Përsëritje e koralet ⁵	
3.		2.3. Kënga "Lule bore" S. Gjoni	Situata e të nxënës: Muzika shkodrane <i>Jare shkodrane</i> Përmes kësaj fjale nxënësit nxiten të flasin rreth muzikës qytetare shkodrane dhe asaj çka dinë rreth jareve. Ata këndojnë fragmente nga disa këngë. Ata sjellin emra këngëtarësh apo kompozitorësh, duke sjellë edhe fakte apo histori nga jetët e tyre.
4.		2.4. Përsëritje e këngës	
5.		2.5. "Në qetësinë e natës" J. Brams	Situata e të nxënës: Lirika në letërsi dhe muzikë <i>Ninullë</i> <i>Këngë djepi</i> Përmes këtyre fjalëve kyçe, nxënësit rikujtojnë se çfarë kanë bërë në pjesën e lirikës në letërsi dhe kush bën pjesë në këtë zhanër. Ata kujtojnë të gjitha gjinitë ku ndër to bën pjesë edhe ninulla.

4 Të nderuar kolegë, përfundimi i tremujorit të parë llogaritet kur keni plotësuar 12 tema/javë mësimore.

5 Në orën e përsëritjes së këngëve, nuk planifikohet situata të nxënë sepse është përforcim i melodisë.

6.	2.6. Përsëritje e këngës			<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
7.	2.7. “Moj e bukura More” R. Dhomi		Situata e të nxënëit: Arbëria dhe arbëreshët Rikujtohet nga mësimet e historisë fakte nga ikja e 500 mijë shqiptarëve drejt Italisë pas vdekjes së Skënderbeut dhe humbjes së luftërave. Flitet për Arbërinë dhe arbëreshët, traditat dhe zakonet e tyre të cilat janë ruajtur ndër shekuj.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - figura /foto; - Cd.
8.	2.8. Përsëritje e këngëve			<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
	2.9. “ Koralja “Oda e gëzimit” L. V. Bethoven		Situata e të nxënëit: Himni Evropian <i>BE</i> <i>Bethoven</i> <i>Simfonia IX</i> Nxënësit flasin rreth BE dhe pse është e rëndësishme për shqiptarët hyrja në BE. Ata rikujtojnë nëse dinë himnin evropian, i cili është shkëputur nga simfonia IX e Bethovenit.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshatura nga mësuesi; - figura /foto; - CD.
	2.10. Përsëritje e këngëve			<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
	2.11. Përsëritje e këngëve			<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
	2.12. Përsëritje e këngëve			<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
	2.13. Përsëritje e këngëve			<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.

	2.14. Përsëritje e këngëve		<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
Teknika dhe procese	2.15. Përsëritje e këngëve		<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
	2.16. Përsëritje e këngëve		<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
	2.17. Përsëritje e këngëve		<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
	2.18. Përsëritje e këngëve		<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
	2.19. Përsëritje e këngëve		<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
	2.20. Muzika në Mesopotami, Egjipt, Indi dhe Kinë	<p>Situata e të nxënësit: Kultura dhe popujt në qytetërimet e lashta <i>Harta e qytetërimeve të lashta</i> <i>Shirirja gjeografike e e qytetërimeve të lashta</i> <i>Kultura e qytetërimeve të lashta</i> <i>Prodhimet dhe ekonomia e e qytetërimeve të lashta</i> Janë disa fjalë kyçe që i nxisin nxënësit diskutojnë në klasë rreth e qytetërimeve të lashta karakteristikat kulturore, arkitektonike, historike etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi; - materiale të përgatitura nga nxënësit; - foto; - CD.
	2.21. Muzika në Greqinë dhe Romën e lashtë	<p>Situata e të nxënësit: Zgjero situatën e mësipërme me të dhëna të reja</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale të ndryshme burimore; - foto; - CD.

		2.22. Muzika në mesjetën e hershme	Situata e të nxënës: Zbulimi i Amerikës Vendosen foto dhe fakte nga periudha e mesjetës, ku një prej tyre është edhe zbulimi i Amerikës. Nxënësit flasin ngjarje historike, kulturore, fetare që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe, duke I renditur ato.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale të ndryshme burimore; - foto/CD.
		2.23. Dëgjime muzikore dhe reflektive		
		2.20. SHFAQJE MUZIKORE		
Metodologjia				
<ul style="list-style-type: none"> - Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse. - Puna në grup dhe puna individuale. - Hetimi dhe zbulimi. - Zbatime praktike Brenda dhe jashtë klase. Metoda integruese. - Bashkëbisedim për tema të caktuara. - Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues. - Prezantime në forma të ndryshme, përmes Teknologjisë. - Projekte individuale dhe në grup. - Shfaqje përmblyëse ose detyra përmblyëse (përfundimi me sukses i arritjeve) 				
Vlerësimi:				
<ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi përshkrues, - vlerësimi i tematikave përmblyëse, - vlerësimi i dosjes. 				

PLANIFIKIMI DITOR PËR 3 MUJORIN E DYTË – JANAR – MARS 5 MËSIMI MODEL

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12-të
Tematika: Teknika dhe procese muzikore	Situata e të nxënësve: Muzika shkodrane <i>Jare shkodrane</i> Përmes kësaj fjale nxënësit nxiten të flasin rreth muzikës qytetare shkodrane dhe asaj çka dinë rreth jareve. Ata këndojnë fragmente nga disa këngë. Ata sjellin emra këngëtarësh apo kompozitorësh, duke sjellë edhe fakte apo histori nga jetët e tyre.		
Tema mësimore: Kënga “Lule bore”			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none">- komunikon qartë informacionin që ka për <i>jaret shkodrane</i>;- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve;- këndon vetëm dhe në grup.	Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none">- melodia e këngës;- teksti i këngës;- rregullat e këndimit;- muzika qytetare shkodrane.		
Burimet: <ul style="list-style-type: none">- teksti i nxënësit;- materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi;- figura /foto;- kënga në CD.	Lidhja me lëndët e tjera: <ul style="list-style-type: none">- 1		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos për nxënësit të dëgjojnë në Cd disa fragmente nga <i>jare të ndryshme shkodrane</i> . Përmes tyre nxënësit nxiten të flasin rreth muzikës qytetare shkodrane dhe asaj çka dinë rreth jareve. Ata këndojnë fragmente nga disa këngë. Ata sjellin emra këngëtarësh apo kompozitorësh, duke sjellë edhe fakte apo histori nga jetët e tyre.			

Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me **hapin II**, ku mësuesi **vendos** në CD për dëgjim kënga “Lule bore”.

- **Nxiten** nxënësit të flasin duke thënë nëse kënga do të ishte më e bukur dhe krijon emocion përmes vetëm muzikës apo përmes të dyjave së bashku?
- **Vendoset** përsëri kënga dëgjim dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj , sipas hapave të mëposhtëm:

- këndimi varg pas vargu;
- përsëritja e vargjeve herë pas here;
- këndimi i strofës;
- këndimi i strofës dhe refrenit;
- përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
- interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
- këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

Gjatë mësimin të këngës, kujdes të respektohet ritmi, intonacioni, interpretimi i këngës.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- komunikimin qartë informacionin që ka për *jaret shkodrane*;
- këndimin duke respektuar rregullat e përcaktuara;
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve;
- - këndimin vetëm dhe në grup.

Detyra:

Ese/Krijim individual:

- a) kërkim nga burime të ndryshme muzikore interpretime nga këngëtarë të ndryshëm shkodranë (krijim i CD) ose
- b) përshkrim i emocioneve nga këngë të ndryshme shkodrane.

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12
Tematika: Teknika dhe procese muzikore Tema mësimore: Koralja “Ave Maria”		Situata e të nxënës: Murgesha gazmore Rikujtohet ky film me nxënësit ose shikohen fragmente nga ky film. Çfarë lloj këngësh këndonin murgeshat? Ku i këndonin ato? A duhet të kishin një formim vokal që të këndonin ato?	

<p>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - komunikon qartë informacionin që ka për muzikën kishtare të periudhës në të cilën është krijuar koralja; - këndon në grup duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara në grup; - interpreton koralen me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - korale; - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit; - muzika kishtare.
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Teksti i nxënësit, - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi, - figura /foto, - kënga në Cd. 	<p>Lidhja me lëndët e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat dhe shoqëria: histori dhe gjeografi
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p> <p>Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos për nxënësit të dëgjojnë në DVD disa fragmente nga filmi “Murgesha gazmore” duke rikujtuar momente nga ky film. Çfarë lloj këngësh këndonin murgeshat? Ku i këndonin ato? A duhet të kishin një formim vokal që të këndonin ato?</p> <p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <p>Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me hapi II, ku mësuesi vendos në CD për dëgjim koralen “Ave Maria”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxiten nxënësit të flasin rreth karakteristikave që ka të kënduarit në kor/grup dhe karakteristikat e vetë melodisë. • Më pas lexohen me kujdes fjalët e koralet pasi ato janë në latinisht, duke u kujdesur të vendoset theksi i fjalës aty ku duhet. • Vendoset përsëri koralen dëgjim dhe vazhdohet puna me mësimin e saj , sipas hapave të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> - këndimi varg pas vargu; - përsëritja e vargjeve herë pas here; - përsëritja e koralet nga fillimi në fund; - interpretimi i koralet me ndjenjë dhe emocion; - këndimi i koralet në grup sipas rregullave. <p>Gjatë mësimin të koralet, kujdes të respektohet ritmi, intonacioni, interpretimi i saj.</p>	

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- komunikimin qartë të informacionit që ka për *muzikën kishtare*;
- këndimin në grup duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara në grup;
- interpretimin e korales me ndjenjë dhe emocion sipas karakterit të veprës;
- respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve.

Detyra:

Ese/Krijim individual:

- a) kërkim nga burime të ndryshme muzikore mbi muzikën kishtare dhe koraleve të ndryshme të krijuara në mbi këtë lloj stili;
- b) përshkrim i emocioneve nga korale të ndryshme që janë gjetur në internet dhe janë dëgjuar me kujdes.

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12
Tematika: Teknika dhe procese muzikore Tema mësimore: Kënga “Moj e bukura more”		Situata e të nxënët: Arbëria dhe arbëreshët <i>Arbëri</i> <i>Arbëresh</i> <i>Gjuha arbëreshe</i> Mbi këto fjalë fillon rikujtimi nga mësimet e historisë fakte nga ikja e 500 mijë shqiptarëve drejt Italisë pas vdekjes së Skënderbeut dhe humbjes së luftërave. Flitet për Arbërinë dhe arbëreshët, traditat dhe zakonet e tyre të cilat janë ruajtur ndër shekuj.	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon me argumente ikjen e shqiptarëve në Itali dhe ruajtjen e traditave dhe zakoneve; - këndon këngën duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - - këngë arbëreshe; - - melodia e këngës; - - teksti i këngës; - - rregullat e këndimit; - - muzika arbëreshe. 	

<ul style="list-style-type: none"> - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; - këndon vetëm dhe në grup. 	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit, - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura /foto; - kënga në CD. 	Lidhja me lëndët e tjera: Shkenca dhe shoqëria: Historia, gjeografia, letërsia, arti pamor (kostumografia)
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<p><i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i></p> <p>Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos për nxënësit disa fjalë kyçe:</p> <p><i>Arbëri</i> <i>Arbëresh</i> <i>Gjuha arbëreshe</i> <i>Veshjet arbëreshe</i></p> <p>Mbi këto fjalë fillon rikujtimi nga mësimet e historisë fakte nga ikja e 500 mijë shqiptarëve drejt Italisë pas vdekjes së Skënderbeut dhe humbjes së luftërave. Flitet për Arbërinë dhe arbëreshët, traditat dhe zakonet e tyre të cilat janë ruajtur ndër shekuj.</p> <p>Hapi II: Dëgjojnë këngën “Moj e bukura more: në CD. Përmes saj nxënësit nxiten të flasin rreth muzikës arbëreshe dhe asaj çka dinë rreth këngët arbëreshe .</p>	
<p><i>Ndërtimi i njohurive të reja</i></p> <p>Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me <i>hapin III</i>, ku mësuesi vendos përsëri këngën për dëgjim dhe vazhdohet puna me mësimin e saj sipas hapave të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - këndimi varg pas vargu; - përsëritja e vargjeve herë pas here; - këndimi i strofës; - këndimi i strofës dhe refrenit; - përsëritja e këngës nga fillimi në fund; - interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion; - këndimi i këngës vetëm dhe në grup. <p>Gjatë mëimit të këngës, kujdes të respektohet ritmi, intonacioni, interpretimi i saj.</p>	

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- këndimin e këngës duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- respektimin e interpretimit dhe të performimit të shokëve;
- këndimin vetëm dhe në grup.

Detyra:

Ese/Krijim individual:

- a) kërkim nga burime të ndryshme muzikore interpretime nga këngëtarë të ndryshëm arbëreshë (krijim i CD);
- b) përshkrim i emocioneve nga këngë të ndryshme arbëreshe.

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12
Tematika: Teknika dhe procese muzikore Tema mësimore: Koralja <i>"Oda e g' zimit"</i>		Situata e të nxënës: Himni Evropian <i>BE</i> <i>Bethoven</i> <i>Simfonia IX</i> Përmes fjalëve kyçe, nxënësit flasin rreth BE dhe pse është e rëndësishme për shqiptarët hyrja në BE. Ata rikujtojnë nëse dinë himnin evropian, i cili është shkëputur nga simfonia IX e Bethovenit.	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; - këndon në ritëm dhe intonacion; - interpreton koralen me ndjenjë dhe emocion; 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - - - melodia e këngës; - - teksti i këngës; - - rregullat e këndimit; - - himn. 	

Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura /foto; - koralja në CD. 	Lidhja me lëndët e tjera:
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos për nxënësit disa fjalë kyçe: <i>BE</i> <i>Bethoven</i> <i>Simfonia IX</i></p> <p>Përmes fjalëve kyçe, nxënësit flasin rreth BE dhe pse është e rëndësishme për shqiptarët hyrja në BE. Ata rikujtojnë nëse dinë himnin evropian, i cili është shkëputur nga simfonia IX e Bethovenit.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me hapin II, ku mësuesi vendos në CD për dëgjim koralen “Oda e g’zimit” dhe vazhdohet puna me mësimin e saj sipas hapave të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mësimi i fjalëve të koralet (shqip ose gjermanisht); - këndimi varg pas vargu; - përsëritja e vargjeve herë pas here; - këndimi i strofës; - këndimi i strofës dhe refrenit; - përsëritja e koralet nga fillimi në fund; - interpretimi i koralet me ndjenjë dhe emocion. <p>Gjatë mësimin të koralet, kujdes të respektohet ritmi, intonacioni, interpretimi i saj.</p>	
<p>Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për <i>demonstrimi e rezultateve të arritura në:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - këndimin duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve; - këndimin në ritëm dhe intonacion; - interpreton koralen me ndjenjë dhe emocion; 	

Detyra:**Ese/Krijim individual:**

- a) kërkim nga burime të ndryshme muzikore nga muzika e Bethovenit (krijim me vepra muzikore të tij, në CD);
- b) përshkrim i emocioneve nga muzika e këtij kompozitori.

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12-të ⁶
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria Tema mësimore: “Muzika në Mesopotami, Egjipt, Indi dhe Kinë”		Situata e të nxëniet: Kultura dhe popujt në qytetërimet e lashta <i>Harta e qytetërimeve të lashta</i> <i>Shtrirja gjeografike e qytetërimeve të lashta</i> <i>Kultura e qytetërimeve të lashta</i> <i>Prodhimet dhe ekonomia e e qytetërimeve të lashta</i> <i>CD – Himni i Muzës</i> Janë disa fjalë kyçe që i nxisin nxënësit diskutojnë në klasë rreth <i>e qytetërimeve të lashta</i> karakteristikat kulturore, arkitektonike, historike etj.	
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon shtrirjen gjeografike, kulturore, ekonomike të vendeve ku u zhvilluan qytetërimet e para; - dëgjon dhe argumenton llojin e muzikës dhe instrumentet që ekzekutonin në atë periudhë; - gjykon nëpërmjet fakteve se si ishte e zhvilluar muzika në moment të vështira të jetës njerëzore; - respekton mendimin e shokëve. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - instrument muzikor oud; - tanpura; - liuti. 	

6 Muzika, mund të zhvillohet në klasë të 10, 11 apo 12, në varësi të zgjedhjes që bëhet nga nxënësit dhe shkolla. Ndaj te rubrika e shkallës dhe e klasës vendoset me ndarje p.sh.: Klasa 1-/12 dhe shkalla V/VI.

Burimet: - teksti i nxënësit; - - Shembuj muzikore të parapërgatitura në CD; - - foto dhe harta.	Lidhja me lëndët e tjera: - - Shkenca dhe shoqëria: letërsia, historia, gjeografia.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<p><i>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</i></p> <p><i>Hapi I:</i> Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos ose shkruan në dërrasë.</p> <p><i>Hartën e qytetërimeve të lashta që tregon shtrirjen gjeografike të qytetërimeve të lashta</i></p> <p><i>Kultura e qytetërimeve të lashta</i></p> <p><i>Prodhimet dhe ekonomia e e qytetërimeve të lashta</i></p> <p><i>CD – Himni i Muzës</i></p> <p>Janë disa fjalë kyçe apo kërkesa të drejtuara nga mësuesi që i nxisin nxënësit diskutojnë në klasë rreth <i>e qytetërimeve të lashta</i> karakteristikat kulturore, arkitektonike, historike etj.</p> <p><i>Hapi II:</i> vendoset fragmenti muzikor (CD) “<i>Himni I Muzës</i>” nga Mesomedi i Kretës.</p> <p><i>Hapi III:</i> ndërkohë shpjegohen fillimet e muzikës në Antikitet është periudha gjatë së cilës muzika filloi të merrte kuptimin e një veprimtarie që zhvillohej nga njerëz të veçantë, pavarësisht se ajo ishte shumë e thjeshtë dhe u zhvillua kryesisht në përbërje të tragjedisë e të komedisë antike. Muzika ishte pjesë përbërëse e teatrit antik, art që zhvillohej nga loja e aktorit, skena të ndryshme, regjisorit. Ajo edhe pse shoqëronte dhe pasqyronte figurat teatrore, u zhvillua duke krijuar mundësinë që ajo të zhvillohej si art më vete. Këtë gjë e dëshmojnë materialet e gjetura të historianëve; mbishkrimet e monumenteve, basorelievet apo pikturat murale të cilat na ndihmojnë të zbulojmë dhe kuptojmë se si është zhvilluar bota misterioze e muzikës së antikitetit. Që në lashtësi <i>kënga, fjala, muzika dhe kërcimi</i> kanë qenë të pandara, ndaj themi që arti në ishte <i>sinkretik</i> pasi ai zhvillohej bashkë pra ishte i përbashkët dhe i shumëfishtë. Ndërsa <i>mjetet shprehëse</i> lidheshin me mundësitë shprehëse të vetë trupit të njeriut të cilat përbënë edhe mjetet e para muzikore p.sh.: zëri, përplasja e duarve bashkëveprimi me mjete rrethanaore si druri, guri etj. Njeriu nëpërmjet lëvizjeve, zërit apo shoqërimit me mjete të ndryshme manifestonte emocionet e tij vetëm ose në mënyrë kolektive, duke shprehur format e para të shfaqjeve muzikore.</p>	
<p><i>Ndërtimi i njohurive të reja</i></p> <p>Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me <i>hapi IV</i>, ku mësuesi vendos disa foto duke pare me kujdes fotot imagjinoni se si mund të ketë qenë jeta në qytetërimet e lashta.</p> <p>- Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht rreth tyre</p>	

Hapi V: Vendosen fragmente muzikore (CD me melodi egjiptiane) nga kjo periudhë, duke shprehur mendimin e vet rreth tyre:

çfarë lloj emocioni u krijohet? Si do ta përcaktonin me fjalët e veta këtë lloj muzike? Nxënësit mund të sjellin edhe vetë melodi të ndryshme gjetur nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në *youtube* apo *internet*, këngë apo muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.

Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- evidentimin e shtrirjes gjeografike dhe zhvillimin kulturor, ekonomik të vendeve ku u zhvilluan qytetërimet e para;
- argumentimin pas dëgjimit në CD të llojeve të muzikës dhe instrumenteve që ekzekutojnë në atë periudhë;
- gjykimit nëpërmjet fakteve se si ishte e zhvilluar muzika në qytetërimet e lashta;
- respektimin e mendimit të shokëve.

Detyra:

Kërkim: Gjeni materiale nga burime informacioni të ndryshme duke zgjeruar njohuritë rreth muzikës në antikitet. Nga gjetjet mund të krijoni albume ose CD me muzikë kësaj periudhe.

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

PLANIFIKIMI I TRE MUJORIT : PRILL - QERSHOR

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇE

1. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi:

- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv në veprimtaritë muzikore të përjetimit, dëgjimit dhe analizimit të veprave muzikore;
- gjykon në mënyrë kritike dhe të drejtë mesazhin muzikor të veprës;
- shprehet qartë dhe komunikon saktë estetikisht dhe artistikisht për vepra të ndryshme muzikore;
- komunikon dhe shprehet nëpërmjet mjeteve shprehëse muzikore në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme, kritike dhe krijuese.

2. Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

- përpunon njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;
- zgjidh probleme të ndryshme që lidhen me muzikën apo artin, në jetën e përditshme apo në klasë/shkollë;
- zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese gjatë dëgjimit të një vepre muzikore;
- ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim, projekt apo veprimtari muzikore artistike.

3. Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi :

- vendos njohuritë muzikore në funksion të realizimit të një argumenti, krijimi apo projekti muzikor/artistik;
- përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një punë të vetën mbi artin në përgjithësi apo muzikën në veçanti;
- zhvillon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni.

4. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi :

- zhvillon aftësitë menaxhuese artistike lidhur me një projekt artistik/muzikor;
- drejton aktivitetet muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese;
- inicion aktivitete ndërgjegjëse ndaj ruajtjes së mjedisit, nga zhurmat akustike.

5. Kompetenca personale**Nxënësi :**

- krijon besimin tek vetja, në rolin që ndërmerr gjatë veprimtarive muzikore/artistike;
- merr pjesë dhe kontribuon në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;
- zhvillon vetëbesimin tek aftësitë e veta dhe krijon lirshmëri dhe besim tek të tjerët në realizimin e detyrave artistike.

6. Kompetenca qytetare**Nxënësi :**

- promovon me qytetari, vlerat të ndryshme kulturore dhe muzikore të vendit apo të krahinës;
- respekton punën dhe mendimin e të tjerëve lidhur me çështje artistike / muzikore;
- bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

7. Kompetenca digjitale**Nxënësi :**

- shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet lidhur aspekte të ndryshme kulturore/ muzikore;
- përdor një mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave lëndore

Krijimi muzikor	Performimi/interpretimi muzikor	Vlerësimi muzikor
Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përdor ide të ndryshme për të organizuar mendimin e tij personal estetik muzikor; - zhvillon mendimin e tij personal mbi elementet muzikor gjatë analizimit të veprës muzikore; - shpreh përjetimet dhe përfytyrimet muzikore gjatë dëgjimit muzikor; 	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përjeton emocionalisht gjatë procesit të këndimit, vepra të ndryshme (këngë, kanone, këngë popullore, arie etj), duke zhvilluar një kuptim të qartë të këndimit në grup; - përjeton emocionalisht gjatë procesit të dëgjimit, vepra të ndryshme muzikore (vokale apo instrumentale), duke zhvilluar një kuptim të qartë të veprës muzikore; 	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - zhvillon gjykimin e vet muzikor dhe estetik mbi veprat të ndryshme muzikore; - analizon veprat muzikore (vokale dhe instrumentale) që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë duke u mbështetur veçoritë e veprave muzikore; -

<ul style="list-style-type: none"> - organizon bindjet e veta për të shprehur mesazhin e veprës muzikore; - ndan përvojat e veta muzikore me të tjerët. 	<ul style="list-style-type: none"> - këndon motivet apo temat mjaft të njohura të pjesëve muzikore apo melodive të përzgjedhura (rinjohje nëpërmjet fishkëllimit apo këndimit të temave kryesore); - interpreton mendimin e vet mbi përmbajtjet muzikore të pjesëve të parapëlqyera përmes komunikimit artistik dhe estetik të saj (ese-ja); - ndan përvojat e veta performuese/interpretuese me të tjerë. 	<ul style="list-style-type: none"> - bën krahasimin e veprave muzikore, duke u shprehur me një gjuhë të qartë muzikore dhe përdorur terminologji si: melodi, ritëm, harmoni, formë etj.; - vlerëson veprat muzikore, sipas llojit, autorit, vendit dhe periudhës historike në të cilën është realizuar vepra, duke ndërtuar një gjykim kritik dhe estetik.
---	---	--

PLANIFIKIMI I TREMUJORIT III, PRILL - QERSHOR⁷,

Nr.	Tematika	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënës	Burimet
1.	Historia, muzika dhe shoqëria	3.1 .Muzika në mesjetën e lulëzuar (shek. XI -XV)	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Muzika laike</i> <i>Muzika kishtare</i> <i>Polifoni</i> <i>Ars Nova</i> <i>Instrumentet muzikore</i></p> <p>Fjalët kyçe shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth ngjarjeve në tërësi të kësaj periudhe. Nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuësi; - figura / foto; - CD/DVD.
2.		3.2. Kultura muzikore gjatë Rilindjes	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Galileo Galileu</i> <i>Nikolla Koperniku</i> <i>Rilindje</i> <i>Mikelanxhelo</i> <i>Rafaello</i></p> <p>Fjalët kyçe shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth ngjarjeve në tërësi të kësaj periudhe mbi shkencën, artin etj., dhe të nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuësi; - figura / foto; - CD.

⁷ Të nderuar kolegë, përfundimi i tremujorit të parë llogaritet kur keni plotësuar 12 tema/javë mësimore.

⁸ Në këtë tematikë mund të bëhet një situatë e të nxënës familjare, e cila rimerret në çdo temë mësimore sipas periudhave.

3.	3.3. Shkollat polifonike	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra <i>Polifoni</i> <i>Shkollë polifonike</i> <i>Martin Luteri</i></p> <p>Fjalët kyçe shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth ngjarjeve në tërësi të kësaj periudhe mbi shkencën, artin, ndryshimet në ndikimet e fesë etj., dhe të nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshatura nga mësuesi; - figura / foto; - CD.
4.	3.4. Kultura muzikore në Evropë gjatë periudhës së barokut	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra <i>Luigji XIV</i> <i>Barok</i> <i>Koncert</i> <i>Violinë</i> <i>Antonio Stradivari</i></p> <p>Fjalët kyçe shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth ngjarjeve të kësaj periudhe apo mbi zhvillimin e concerto grossos, mbi artin, etj., dhe të nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore (Koncerti 4 stinët – A.Vivaldi).</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshatura nga mësuesi; - figura / foto, - CD.

5.	3.5. Kompozitorët gjatë periudhës së barokut J. S. Bah dhe ZH. F Hendel	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë-vepra dhe kompozitorë <i>J.S.Bah</i> <i>Hendel</i> <i>Opera</i> Vendosen fjalët kyçe dhe nxiten për të ndihmuar nxënësit të kuptojnë se si u zhvillua muzika dhe kush ishin përfaqësuesit kryesorë të kësaj periudhe.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura / foto; - CD.
6.	3.6. Kultura muzikore gjatë periudhës së klasicizmit	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë-vepra dhe kompozitorë <i>Revolucioni francez</i> <i>Deklarata e pavarësisë në Amerikë</i> <i>Napoleon Bonaparti</i> Fjalët kyçe shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth ngjarjeve të kësaj periudhe apo mbi zhvillimet në tërësi etj., dhe të nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura / foto, - CD/DVD.

7.	3.7. Kompozitorët në klasicizëm Hajden, Moxart, Bethoven	<p>Situata e të nxënësit: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Moxart</i> <i>Hajden</i> <i>Bethoven</i> <i>Opera</i> <i>Sonata</i> <i>Sinfoni</i></p> <p>Ndërtohet një rrjedhë kronologjike e ngjarjeve historike por edhe zhvillimeve muzikore të formave të reja muzikore apo përsosmërisë së tyre. Nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshatatura nga mësuesi; - figura/ foto; - CD.
8.	3.6. Dëgjime muzikore dhe reflektime		<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
9.	3.7. Kultura muzikore në Evropë gjatë periudhës së romantizmit	<p>Situata e të nxënësit: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Varshava</i> <i>Revolucioni industrial</i> <i>Lufta e parë botërore</i></p> <p>Nga fjalët kyçe por edhe nga vepra muzikore të njohura nxiten nxënësit të flasin rreth zhvillimeve të mëdha që ndodhën në këtë periudhë por edhe në muzikë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - figura/ foto; - CD.

10.	3.8. Kompozitorët F.Shubert, F.Shopen, F.List	Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra <i>Muzika instrumentale</i> <i>Etydi – Revolucionari</i> <i>Vals</i>	- teksti i nxënësit; - CD.
11.	3.9. Kompozitorët gjatë periudhës së romantizmit, muzika vokale	Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Muzika vokale</i> <i>Opera bufa</i> <i>Opera seria</i> <i>Opera italiane</i> Karakteristikat dhe problematikat e periudhës të pasqyruar në veprat e kompozitorëve vokale dhe instrumentale.	- teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura/ foto; - CD.
12	3.10. Degjime muzikore dhe reflektime		- teksti i nxënësit; - CD.
13	3.11. Muzika gjatë shekullit XX	Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë Karakteristikat dhe zhvillimi i muzikës në shekullin XX e periudhë ku u pasqyrua gjithë avangarda e muzikës në veprat e kompozitorëve të ndryshëm. Lidhja e kësaj avangarde edhe me artet e tjera: <i>piktura</i> , <i>skulptura</i> etj. Nxiten nxënësit të flasin edhe rreth zhvillimeve të mëdha që ndodhën në këtë periudhë por edhe në muzikë.	- teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura/ foto; - CD.

14	3.12. Muzika moderne	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Xhaz</i> <i>Bluz</i> <i>Rokenroll</i> <i>Metal</i> <i>Hip pop</i> <i>Elvis Presli</i> <i>Beatles</i></p> <p>Fjalët kyçe apo edhe dëgjimi muzikor në CD shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth zhvillimit të muzikës modern përmes rrymave dhe stileve të ndryshme gjatë shekullit XX. Ata nxiten për diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore, ngjarjet që ndodhën këto zhvillime, përfaqësuesit kryesore dh e këngët që bënë epokë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshatura nga mësuesi; - figura/foto; - CD.
----	----------------------	---	---

15	3.13. Muzika shqiptare në lashtësi dhe mesjetë	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Himni Te Deum</i> <i>Niket Dardani</i> <i>Jan Kukuzeli</i></p> <p>Fjalët kyçe shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth fillimeve të muzikë shqiptare të kësaj periudhe si dhe mbi zhvillimet në tërësi etj., dhe të nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura / foto; - CD.
16	3.1.4. Muzika në periudhën e rilindjes	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>O trima luftëtarë</i> <i>Pavarësia</i> <i>Marrëveshja e Londrës për kufijtë</i></p> <p>Fjalët kyçe apo edhe dëgjimi muzikor në CD shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth zhvillimit të muzikës shqiptare gjatë periudhës së pavarësisë, karakterit që kishin këto këngëve dhe pse shërbyen ato gjatë asaj periudhe. Ata nxiten për diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore dhe ngjarjet që ndodhën në Luftën II Botërore, rolin që luajtën këto këngë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi; - materiale të përgatitura nga nxënësit; - foto; - CD.

17	3.15. Përfaqësues të muzikës shqiptare në gjysmën e parë të shek XX	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Opera shqiptare</i> <i>Baleti</i> <i>Sinfonia</i> <i>Tematikat që pasqyrojnë kohën</i> Fjalët kyçe apo edhe dëgjimi muzikor në CD shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të risjellin nëpër mend ato çka dinë për Shqipërinë e këtyre viteve dhe zhvillimit të muzikës profesioniste shqiptare Ata nxiten për diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale interaktive të përshtatura nga mësuesi; - figura/ foto; - CD.
18	3.16. Dëgjime muzikore dhe reflektime		<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - CD.
19	3.17. Muzika profesioniste shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX.	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë Zgjerohet situata e mësimit të mësipërm.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi; - materiale të përgatitura nga nxënësit; - foto; - CD.

20	3.20. Muzika profesioniste kosovare	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë-vepra dhe kompozitorë <i>Aktivitetet kulturore</i> <i>Muzika kosovare</i> <i>Kënga popullore kosovare</i> <i>Muzika profesioniste</i> Fjalët kyçe apo edhe dëgjimi muzikor në CD shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të risjellin nëpër mend ato çka dinë për Shqipërinë e këtyre viteve dhe zhvillimit të muzikës profesioniste shqiptare .Ata nxiten për diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi; - materiale të përgatitura nga nxënësit - foto; - CD.
21	3.21. Muzika vokale profesioniste shqiptare	<p>Situata e të nxënës: Muzika në hapësirë dhe në kohë-vepra dhe kompozitorë <i>Tefia Tashko Koço</i> <i>Gaqo Çako</i> <i>Inva Mula</i> <i>Ermonela Jaho</i> <i>Sajmir Pirgu</i> Emrat e njohur apo edhe dëgjimi muzikor në CD shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të risjellin nëpër mend ato çka dinë për këngëtarët lirikë të muzikës vokale shqiptare, gjatë viteve dhe zhvillimit të muzikës profesioniste shqiptare .Ata nxiten për diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi; - materiale të përgatitura nga nxënësit - foto; - CD.

22	3.22. Muzika e lehtë shqiptare	<p>Situata e të nxënësit: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra <i>Aleksandër Gjoka</i> <i>Gent Demalia</i> <i>Ardian Trebicka</i> <i>Manjola Nallbani</i></p> <p>Emrat e njohur apo edhe dëgjimi muzikor në CD shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të sjellin të dhëna dhe fakte rreth këngëtarëve të muzikës së lehtë shqiptare. Ata nxiten për diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - materiale të përgatitura nga mësuesi; - materiale të përgatitura nga nxënësit - foto; - CD.
23	3.23. Dëgjime muzikore dhe reflektime		
24	3.24. TEST NJOHURISH	Testi	- Testi i përgatitur

<p>Metodologjia</p> <p>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse. Puna në grup dhe puna individuale. Hetimi dhe zbulimi. Zbatime praktike Brenda dhe jashtë klase. Metoda integrale. Bashkëbisedim për tema të caktuara. Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues. Prezantime në forma të ndryshme, përmes Teknologjisë. Projekte individuale dhe në grup. Shfaqje përmbyllëse ose detyra përmbyllëse (përfundimi me sukses i arritjeve)</p>	<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi përshkrues, - vlerësimi i tematikave përmbyllëse, - vlerësimi i dosjes.
--	--

PLANIFIKIMI DITOR PËR 3 MUJORIN E DYTË PRILL – QERSHOR 5 MËSIMI MODEL

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12 ⁹
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria Tema mësimore: “Kultura muzikore gjatë Rilindjes”		Situata e të nxënit: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Galileo Galileu</i> <i>Nikolla Koperniku</i> <i>Rilindje</i> <i>Mikelanxhelo</i> <i>Rafaelo</i> Fjalët kyçe shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth ngjarjeve në tërësi të kësaj periudhe mbi shkencën, artin etj., dhe të nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - - shpjegon ngjarjet që lidhen me periudhën e Rilindjes dhe zhvillimi muzikor; - - shpjegon ndryshimet që ndodhën në art, muzikë, shkencë etj., duke analizuar faktet e kohës; - - argumenton duke krahasuar muzikën e kësaj periudhe me një periudhë tjetër, dhe nxjerr karakteristikat e saj. - - respekton mendimin e shokëve. 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - - rilindje; - - monodi; - - fraza muzikore; - - polifoni. 	

9 Muzika, mund të zhvillohet në klasë të 10, 11 apo 12, në varësi të zgjedhjes që bëhet nga nxënësit dhe shkolla. Ndaj te rubrika e shkallës dhe e klasës vendoset me ndarje p.sh.: Klasa 1-/12 dhe shkalla V/VI.

Burimet: - teksti i nxënësit; - - shembuj muzikore të parapërgatitura në CD; - - foto nga ngjarje që i përkasin kësaj periudhe.	Lidhja me lëndët e tjera: - - letërsia; - - historia; - - arti; - - shkencat.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p> <p>Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos në CD një pjesë muzikore “Klithmat e Parisit” e K. Zhankë.</p> <p>Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth muzikës që dëgjojnë duke diskutuar rreth llojit muzikor që ata dëgjojnë.</p> <p>Hapi II: <i>Galileo Galileu</i> <i>Nikolla Koperniku</i> <i>Rilindje</i> <i>Mikelanxhelo</i> <i>Rafaelo</i></p> <p>Fjalët kyçe shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth ngjarjeve në tërësi të kësaj periudhe mbi shkencën, artin etj., dhe të nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p> <p>Hapi III: ndërkohë shpjegohet Arti muzikor ose ndryshe periudha e quajtur Rilindje u zhvillua gjatë shekullit XV dhe XVI. Gjatë kësaj periudhe u shënuan arritje të mëdha në të gjitha fushat art, letërsi, muzikë, ekonomi. Zbulimet e mëdha gjeografike dhe ekonomike në shekujt XV dhe XVI po e çonin Evropën Perëndimore drejt ndryshimeve shoqërore, historike, kulturore e artistike. Në këtë epokë mbizotëroi lëvizja <i>humaniste</i>, e cila shoqëroi të gjithë periudhën që sot njihet me emrin <i>Rilindje</i>. Në këtë periudhë njerëzit filluan të ndjehen të lirë për të shprehur idetë e tyre intelektuale, kulturore, artistike e shkencore për ndryshime, të cilat sollën zhvillime shumë të mëdha në shkencë. Për herë të parë në këtë periudhë shkenca iu kundërvu parimeve fetare, të cilat ishin respektuar në mënyrë shumë të rreptë deri në atë kohë.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me hapi IV, ku mësuesi vendos disa foto me vepra arti të kësaj periudhe. Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht: <ol style="list-style-type: none"> 1. Pse gjatë kësaj periudhe njerëzit filluan të shprehnin lirshëm idetë e tyre nëpërmjet arteve të ndryshme? Cilët ishin përfaqësuesit kryesorë? 2. Pse themi se në këtë periudhë u bë qartësimi i muzikës polifonike pa ndikimin e muzikës kishtare? <ul style="list-style-type: none"> - <p>Ata përgjigjen duke dhënë mendimet e veta si dhe duke u ballafaquar me njohuritë që morën.</p>	

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- - shpjegimin e ngjarjeve që lidhen me periudhën e Rilindjes dhe zhvillimi muzikor;
- - shpjegimin e ndryshimeve që ndodhën në art , muzikë, shkencë etj., duke analizuar faktet e kohës;
- - argumentimin duke krahasuar muzikën e kësaj periudhe me një periudhë tjetër, dhe nxjerrë karakteristikat e saj;
- - respektimin e mendimit të mendimit të shokut/ shoqes.

Detyra:

Kërkim: materiale dhe të dhëna mbi artin dhe muzikën të zhvilluar gjatë kësaj periudhe.

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12¹⁰
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria Tema mësimore: “Kultura muzikore gjatë periudhës së klasicizmit”		Situata e të nxënit: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Revolucioni francez</i> <i>Deklarata e pavarësisë në Amerikë</i> <i>Napoleon Bonaparti</i> Fjalët kyçe shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth ngjarjeve të kësaj periudhe apo mbi zhvillimet në tërësi etj., dhe të nxiten diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore .	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon ngjarjet historike, artistike; ekonomike, politike, që lidhen me periudhën e klasicizmit; - shpjegon risitë e periudhës dhe zhvillimet e mëtejshme që ndodhën në muzikë (opera bufa, seria, gjinitë e reja që lindën); 		Fjalët kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - klasicizëm; - opera seria - opera bufa; - simfonia; - sonata; - trio. 	

10 Muzika, mund të zhvillohet në klasë të 10, 11 apo 12, në varësi të zgjedhjes që bëhet nga nxënësit dhe shkolla. Ndaj te rubrika e shkallës dhe e klasës vendoset me ndarje p.sh.: Klasa 1-/12 dhe shkalla V/VI.

<ul style="list-style-type: none"> - argumenton duke krahasuar një vepër të kësaj periudhe me një vepër muzikore të periudhës barok, duke renditur disa karakteristika; - krijon linjën e kohës në të cilën u zhvillua muzika, gjinitë e ndryshme, instrumentet dhe përfaqësuesit duke e prezantuar në klasë; - respekton mendimin e shokëve. 	
Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - shembuj muzikorë të parapërgatitura në CD; - foto ose materiale të tjera. 	Lidhja me lëndët e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - letërsia; - historia; - arti.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësvë	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësvë</p> <p>Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos në CD <i>kohën e parë të simfonisë – molto allegro</i> CD.</p> <p>Hapi II: Pasi nxënësit e dëgjojnë nxiten të diskutojnë rreth muzikës që dëgjuan, muzikë e cila nga vetë karakteri është mjaft alegro si melodi. Bëhen disa pyetje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Si e përjetoni ju melodinë? - Dinamikat përgjatë melodisë janë forte-piano? - Tingëllimi shumë i shpejtë i tingujve që herë ngjiten lart dhe herë zbresin poshtë. <p>Hapi III: Vendosen disa foto <i>nga Revolucionin francez/ Napoleon Bonaparti dhe ngjarje të tjera të asaj periudhe</i>, dhe nxënësit diskutojnë më gjerë rreth tyre.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me hapin IV, ku mësuesi shpjego më tej rreth zhvillimeve muzikore gjatë kësaj periudhe. <p>Gjysma e dytë e shek. XVIII njohu një revolucion të vërtetë të mendimit dhe të ideve. Kjo lëvizje me emrin <i>iluminizëm</i> (ndriçoj) nuk lindi rastësisht, por i pati rrënjët në ndryshimet ekonomiko-shoqërore që ndodhën si pasojë e revolucioneve borgjeze, veçanërisht të Revolucionit Borgjez Francez (1789) dhe të Revolucionit Amerikan (lufta për pavarësi 1776–1783).</p> <p><i>Iluminizmi</i> kishte si qëllim të ndriçonte mendjen e njerëzve për t'u larguar nga injoranca dhe besëtytnitë e për t'i kthyer sytë nga shkenca dhe kultura. Zbulimet e mëdha shkencore dhe përmbajtja revolucionare e ideve iluministe u bënë mbështetje e fuqishme edhe për shndërrimet në fushat shoqërore. Karakteristika kryesore të lëvizjes ideo-artistike të kësaj periudhe në Evropë është shprehja e gjendjes shpirtërore zotëruese të epokës; <i>e zhgënjimit dhe e pakënaqësisë ndaj realitetit ekzistues</i>.</p>	

Format dhe mënyrat e shprehjes së kësaj pakënaqësie ishin të larmishme. Ato merrnin karakter dhe drejtime të ndryshme. Pikërisht për këto arsye dhe për të tjera, të cilat lidhen me gjithë lëvizjen shoqërore të kohës, kjo pjesë e shekullit do të mbyllet me periudhën e klasicizmit në muzikë, periudhë në të cilën arti muzikor fitoi tipare të reja, duke u ndarë nga stili i ngarkuar dhe plot fantazi i barokut.

Kulmin e saj madhështor periudha klasike e arriti me perfeksionimin e *simfonisë* në formë dhe përmbajtje, si dhe me lindjen e një koncepti të ri e të madh muzikor siç ishte forma e *sonatës klasike* etj...

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- lidhjen e njohurive që ka me ngjarjet historike, artistike, politike, që lidhen me periudhën e klasicizmit;
- shpjegimin e risive të periudhës dhe zhvillimeve të mëtejshme që ndodhën në muzikë (opera bufa, seria, gjinitë e reja që lindën);
- krahasimin e një veprë muzikore të së njëjtës lloj të kësaj periudhe me një vepër muzikore të periudhës Barok, duke renditur disa karakteristika;
- prezantimin e linjës së kohës në të cilën u zhvillua muzika, gjinitë e ndryshme, instrumentet dhe përfaqësuesit;
- respektimin e mendimit të mendimit të shokut/shoqes.

Detyra:

Kërkim: Gjeni materiale nga burime informacioni të ndryshme (foto, piktura, dokumente historike) për të zgjeruar më tej njohuritë rreth karakteristikave të kësaj periudhe, duke u ndalur te momentet që bënë jehonë.

Kërkim: Gjeni materiale nga burime informacioni të ndryshme për të zgjeruar më tej njohuritë biografike dhe muzikore rreth përfaqësuesve të muzikës klasike dhe veprave që ata kompozuan. Krijoni album në CD me muzikën e kësaj periudhe.

Ese: Duke dëgjuar një veprat muzikore të L. V. Bethovenit apo V. A. Moxart përshkruani përjetimin tuaj emocional rreth muzikës së dëgjuar.

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12-të ¹¹
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria Tema mësimore: "Muzika moderne"		Situata e të nxënët: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Khaz</i> <i>Bluz</i> <i>Rokenroll</i> <i>Metal</i> <i>Hip pop</i>	

11 Muzika, mund të zhvillohet në klasë të 10, 11 apo 12, në varësi të zgjedhjes që bëhet nga nxënësit dhe shkolla. Ndaj te rubrika e shkallës dhe e klasës vendoset me ndarje p.sh.: Klasa 1-/12 dhe shkalla V/VI.

	<p>Fjalët kyçe apo edhe dëgjimi muzikor në Cd shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të kërkojnë rreth zhvillimit të muzikës modern përmes rrymave dhe stileve të ndryshme gjatë shekullit XX. Ata nxiten për diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore, ngjarjet që ndoqën këto zhvillime, përfaqësuesit kryesore dhe këngët që bënë epokë.</p>
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon rëndësinë që ka muzika modern në jetën shoqërore; - krahason zëra vokale d.m.th këngëtarë, instrumentistë të rrymave të ndryshme moderne; - krijon një CD me këngët dhe këngëtarët e muzikës moderne të parapëlqyer; - performon këngën e parapëlqyer. 	<p>Fjalët kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - moderne; - xhaz; - rok; - bluz.
<p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - shembuj muzikore të parapërgatitura në CD; - fragmente kryesore nga filma me jetën e këngëtarëve apo instrumentistëve (Elvis Presli, Rei Çarls, Uitni Hjuston, Xhimi Hendriks etj.) në DVD. 	<p>Lidhja me lëndët e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - historia
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p> <p>Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos në CD për dëgjim disa pjesë muzikore vokale ose instrumentale të luajtura apo kënduara nga njerëz të mëdhenj të kësaj muzike.</p> <p>Nxënësit gjejnë kush janë dhe diskutojnë rreth muzikës që ata luajnë apo këndojnë. Ata ndërthurin njohuritë që kanë me kohën kur u zhvilluan këto stile muzikore, ngrenë çështje, argumentojnë, shpjegojnë apo reflektojnë për ngjarje, instrumente apo fakte reale.</p>	

Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me *hapin IV*, ku mësuesi vendos në Cd këngë të ndryshme dhe fillon shpjegimin. *Hapi III*: ndërkohë shpjegohet rreth lindjes së muzikës bluz, xhaz, rok etj. Si lindën këto lloj muzikash dhe pse u pëlqyen dhe u mirëpritën nga masat.

Ritëm& Bluz

Muzika R&B (rhythm and blues) është një lloj muzike shumë popullore, që gërsheton xhazin me muzikën bluz dhe u luajt për herë të parë nga artistët amerikanë me ngjyrë. Në vitin 1947 kjo lloj muzike kishte hyrë tashmë në tregun muzikor, ndërsa emir me të cilin njihet dhe sot, iu vendos në vitin 1949. Deri në fund të viteve 1950, ajo qe bërë e famshme dhe shumë kompani regjistrimi disqesh kishin prodhuar mijëra albume me këtë lloj muzike.

Muzika Rok

Muzika rock është një lloj muzike e përcaktuar gjerësisht, që u zhvillua në vitet 1960, me rrënjët e veta nga muzika rock 'n' roll dhe rockabilly, të cilat në vetvete rrjedhin nga muzika *rhythm and blues*, *country* dhe ndikime të tjera. Në shtesë të kësaj, muzika rok është influencuar edhe nga lloje të tjera muzike si muzika folk, xhaz dhe ajo klasike.

Muzika Hip Hop/ Rap

Hip Hopi është një kulturë që ka prejardhjen nga Nju Jork, DJ Afrika Bambataa ka bërë hapat e parë të kulturës së hip hop-it duke qënë MC, DJ, duke bërë "beatbox". Së pari, hip hop-I ka filluar të krijohet nga DJ-ët të cilët kanë krijuar tingujt ritmik në dy pllaka. DJ Kool Herc është ai që ka pasur mjaft rëndësi në zhvillimin e hip hop-it. Në hip hop hyjnë : Dj, reperët, grafitët etj. Duhet ditur që të bëhet dallimi mes hip hop-it dhe rap-it. Rap-I është pjesë përbërëse e hip hop-it, pra ai që bën muzikë rap themi se është përfshirë në hip hop. Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në *youtube* apo *internet*, këngë apo muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.

Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për *demonstrimi e rezultateve të arritura në:*

- - shpjegimin e rëndësisë që ka muzika modern në jetën shoqërore;
- - krahasimin e zërave vokale dmth këngëtarë, instrumentistë të rrymave të ndryshme moderne;
- - krijimin e një Cd me këngët dhe këngëtarët e muzikës moderne të parapëlqyer;
- - performimin e këngës së parapëlqyer.

Detyra:

Krijim: CD me këngë të ndryshme të këtyre rrymave dhe *materiale shoqëruese biografike*.

Ese: Mbresat rreth këngëve të parapëlqyera. Punë individuale.

Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.

12

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: V	Klasa: 10/12-të ¹²
<p>Tematika: Historia, muzika dh shoqëria</p> <p>Tema mësimore: “Muzika e lehtë shqiptare”</p>		<p>Situata e të nxënit: Muzika në hapësirë dhe në kohë- vepra dhe kompozitorë <i>Aleksandër Gjoka</i> <i>Gent Demaliaj</i> <i>Ardian Trebicka</i> <i>Manjola Nallbani</i> Emrat e njohur apo edhe dëgjimi muzikor në CD shërbejnë për të ndihmuar nxënësit të sjellin të dhëna dhe fakte rreth këngëtarëve të muzikës së lehtë shqiptare. Ata nxiten për diskutime dhe argumentime bazuar edhe në dëgjimet muzikore.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shpjegon rëndësinë që ka muzika e lehtë në jetën shoqërore; - krahason zëra vokale d.m.th këngëtarë, të muzikës së lehtë duke veçuar karakteristikat e tyre; - krijon një CD me këngët dhe këngëtarët e muzikës së lehtë shqiptare të parapëlqyer; - performon këngën e parapëlqyer. 		<p>Fjalët kyçe: - muzikë e lehtë.</p>	

12 Muzika, mund të zhvillohet në klasë të 10, 11 apo 12, në varësi të zgjedhjes që bëhet nga nxënësit dhe shkolla. Ndaj te rubrika e shkallës dhe e klasës vendoset me ndarje p.sh.: klasa 1-/12 dhe shkalla V/VI.

Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit; - - shembuj muzikore të parapërgatitura në CD; - - fragmente kryesore nga filmat e rekomanduar në tekst (DVD). 	Lidhja me lëndët e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - - letërsia; - - historia.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve</p> <p>Hapi I: Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi vendos në një Cd disa këngë të kënduara nga këngëtarë të muzikës së lehtë ndër kohëra. Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth këngëve që dëgjojnë duke folur për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zërat dhe karakteristikat; - interpretimin e këngës; - melodia dhe teksti i këngës; - tematika që trajton etj. 	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veprimtaria mësimore vazhdon më tej me <i>hapi II</i>, ku jepen disa njohuri rreth zhvillimit të muzikës së lehtë në Shqipëri, përfaqësuesit dhe problemet që janë hasur në krijimin e tyre. - Nxiten nxënësit të përshkruajnë shkurtimisht rreth asaj: - - çka dinë rreth këngëve muzikës së lehtë; - - çfarë përfaqësonin ato për kohën; - - nga kush këndoheshin. <p>Nxënësit mund të sjellin konkretisht nëpërmjet njohurive apo hulumtimeve që kanë bërë në <i>youtube</i> apo <i>internet</i>, këngë apo muzikë të tjera në funksion të temës mësimore, sipas parapëlqimeve që ata kanë.</p> <p>Ata diskutojnë për karakteristikat dhe të veçantat që ato kanë dhe sqarojnë pse për ta këto karakteristika janë të pëlqyeshme.</p>	
<p>Vlerësimi</p> <p>Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për <i>demonstrimi e rezultateve të arritura në:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - - shpjegimin e rëndësisë që ka muzika e lehtë në jetën shoqërore; - - krahasimin e <i>zërave vokale d.m.th këngëtarëve shqiptarë</i>, të muzikës së lehtë duke veçuar karakteristikat e tyre; - - krijimin e një CD me këngët dhe këngëtarët e muzikës së lehtë shqiptare të parapëlqyer; - - performimin e këngës së parapëlqyer. 	
<p>Detyra:</p> <p>Krijim: CD me këngë të ndryshme të muzikës së lehtë shqiptare dhe <i>materiale shoqëruese biografike</i>.</p> <p>Ese: Mbresat rreth këngëve të parapëlqyera. Punë individuale.</p> <p>Punët dhe detyrat për temën e trajtuar sipas kërkesave punuar nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.</p>	

VLERËSIMI

Llojet e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik dhe përfundimtar.

Vlerësimi periodik tremujor përfshin:

- *Vlerësimin e vazhdueshëm që del nga evidencat e vlerësimit të vazhduar të mbajtura për periudhën tremujore.*
- *Vlerësimin me test ose detyrë përmbledhëse në përfundim të periudhës tremujore.*
- *Vlerësimin e dosjes (portofolit) së nxënësit për periudhën tremujore.*

Vlerësimi i vazhduar

- 1) Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësve në të gjitha aspektet e të nxënës, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.
- 2) Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.

Për vlerësimin e vazhduar të arritjes së rezultateve të të nxënës, mësuesi mban shënime në evidencë për çdo nxënë. Shënimet në evidencë mund të mbahen me notë, simbole, komente etj. referuar niveleve të arritjes. Këto shënime përdoren nga mësuesit për të argumentuar vlerësimet e kryera përgjatë tremujorit. Në lidhje me këto vlerësime, mësuesit duhet:

- të marrin parasysh dhe të paraqesin rezultatet e të nxënës për të cilat nxënësit janë duke punuar;
- të japin shembuj që ilustrojnë rezultatet e pritshme;
- të përcaktojnë kriteret e suksesit përmes diskutimeve ndërmjet tyre dhe me nxënësit;
- të krijojnë mundësi që nxënësit të demonstrojnë njohuritë, të kuptuarin, aftësitë dhe qëndrimet e tyre.

Mësuesit duhet të marrin në konsideratë balancën ndërmjet njohurive, shkathtësive, qëndrimeve, ashtu siç përshkruhet në rezultatet e të nxënës.

- 3) Mësuesi është i lirë të përshtatë formatin e evidencës (modeli bashkëlidhur), në varësi të specifikave të lëndës, ose të krijojë një formë tjetër të mbajtjes së shënimeve, duke ruajtur pjesën përmbajtësore të saj.

Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse

- 1) Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxënës,

në përfundim të tremujorit. Ky vlerësim e orienton mësuesin për të përmirësuar mësimdhënien dhe procesin e të nxënit.

Vlerësimi me portofol

- 1) Vlerësimi i nxënësit bazuar në portofol, bëhet në përfundim të tremujorit dhe ka për qëllim vëzhgimin dhe vlerësimin e nxënësit në një kontekst të gjerë, duke përfshirë dokumentimin e kontributeve dhe arritjeve të tij për fushën, lëndën, për kompetencat kyçe, për punën individuale dhe në grup, krijimtarinë, talentin, si dhe për aspekte të gjykimit dhe reflektimit të nxënësit për veten dhe të tjerët.
- 2) Portofoli i nxënësit përmban:
 - punë dhe detyra të pavarura, të kryera në klasë dhe jashtë saj;
 - projekte individuale ose në grup;
 - detyra dhe kontribute të nxënësit, të cilat janë dëshmi e talentit, e hulumtimeve praktike, e punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.);
 - vetëvlerësimet e nxënësit;
 - reflektime të prindit ndaj ecursisë së fëmijës.

Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor. Nota vjetore përfundimtare përfshin:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhdueshëm të tri periudhave tremujore.*
- *Notën vjetore të vlerësimit me test ose detyrë përmbledhëse të tri periudhave tremujore.*
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit të tri periudhave tremujore.*

Secili lloj i vlerësimit në notën vjetore përfundimtare ka peshën e vet në përqindje.

Tabela: Peshat në përqindje të llojeve të vlerësimit

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i dosjes (portofolit) së nxënësit	20%

Hapat për njehsimin e notës vjetore përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhdueshëm (NVV)
- Përcaktohet nota vjetore e testit ose detyrës përmbledhëse (NVT)
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit (NVP)
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., nota 6.4 rrumbullakoset 6; nota 6.5 rrumbullakoset 7)

$$(NVV \times 0.4) + (NVT \times 0.4) + (NVP \times 0.2) = \text{Nota vjetore përfundimtare}$$

Shembull:

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Nota vjetore			Nota vjetore përfundimtare
NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	
8	9	10	9	10	10	8	10	10	8	10	10	

$$(8 \times 0.4) + (10 \times 0.4) + (10 \times 0.2) = 9.2$$

Nota vjetore përfundimtare 9